



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Inxhinieri Matematike dhe Informatike”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.asoc. Elson Agastra

2. Prof. Dr. Kostaq Hila

Dhjetor/ 2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës së Aplikuar
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”
4	Urdhëri/ VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr. 5166, datë 16.07.2007
5	Urdhëri/ VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS Nr. 297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/ VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (v.a 2021- 2022)	28 PAE/ 14 PAK Ngarkesa në orë: 2188/328 (87%/13%)
18	Numri i studentëve: (v.a 2018- 2021)	283 student
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është një Institucion publik i arsimit të lartë, më i vjetri dhe më i madhi në vendin tonë dhe i krijuar në vitin 1957. Institucioni është riakredituar me vendim nr. 84 datë 27.10.2018 me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri me 26.10.2022. Universiteti i Tiranës përbëhet nga 6 Fakultete dhe 2 Institute. Fakulteti i Shkencave të Natyrës përbëhet nga 8 departamente ku përfshihet edhe Departamenti i Matematikës së Aplikuar.

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematik dhe Informatike” përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Matematikës së Aplikuar, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës dhe është lincuesuar me dokumentin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, Nr.5166, datë 16.07.2007. Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të Universitetit të Tiranës për aplikim për akreditimin e programeve të studimit drejtuar ASCAL-it, më datës 26.10.2021, Nr. 2837 Prot.

Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit Europian të Transferimit të Krediteve në 180 kredite ECTS, ku në përfundim të tij përfitohet Diplomë Universitare Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”.

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i Matematikës së Aplikuar duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe Departamentit. Qëllimi i këtij programi studimi është: Të formojë specialistë me konceptet bazë teorike dhe praktike në fushën e matematikës së aplikuar dhe shkencat kompjuterike, në mësimdhënien e matematikës së aplikuar dhe në fusha të ndryshme ku aplikohen njohuritë e matematikës së aplikuar: probabilitet, statistikë, analizë numerike, kërkim operacional, analizë të dhënash dhe modelim në fusha të ndryshme të ekonomisë, në përputhje me nevojat zhvillimit të vendit; të nxitë kërkimin shkencor në fushën e matematikës së aplikuar; të promovojë risitë në fushën e matematikës së aplikuar dhe të frymëzojë të rinjtë drejt kësaj fushe; të aftësojë studentët për të analizuar dhe interpretuar të dhënat dhe rezultatet që lindin nga situata reale; të rritë aftësinë e studentëve për të përditësuar njohuritë e tyre në matematikë, informatikë apo statistikë për t’ju përshtatur nevojave të tregut të punës që janë gjithmonë në ndryshim; të zhvillojë një mësimdhënie bashkëkohore, duke u fokusuar në rritjen e cilësisë së saj.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”.

Bazuar në Urdhër nr. Nr. 68, Datë 10.06.2022 me nr. 52/5 Prot. ASCAL, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, për procesin e akreditimit e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti i Tiranës”, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

1. Prof. Asoc. Elson Agastra
2. Prof. Dr. Kostaq Hila

Gjatë gjithë procedurës grupi i vlerësimit të jashtëm është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Maj 2022. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti i Tiranës për të përmbushur objektivat e tij si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti i Tiranës, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër evidencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe VKM 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar.

Takimet në institucion, u zhvilluan në dy ditë sipas programit të miratuar nga ASCAL në datat 7.07.2022 dhe 8.07.2022. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive midis përfaqësuesve të institucionit dhe grupit të vlerësimit të jashtëm, dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Takimet konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Drejtuesen e Departamentit të Matematikës, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik, studentët, përfaqësues të Degës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, përfaqësues të Zyrës së Kurrikulës dhe Degës së Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë; si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët

nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj.

Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Më datë 08/11/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/142 Prot., datë 08/11/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

UT kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 02/12/2022.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

- 1. Koment i IAL mbi “ndarjen e veprimtarive në kategori formuese (ABCDE), GVJ evidenton se lëndët e kategorisë C (LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE) përbëjnë 10% të numrit total të krediteve (ECTS), 2% më pak se minimumi i parashikuar nga VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.”**

Theksojmë se lënda "Informatike 3", me 8 kredite (ECTS), që përbëhet nga grup-lëndë me zgjedhje dhe zhvillohet në vitin III të studimeve, sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 duhej të klasifikohet në kategorinë C (LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE). Në planin mësimor, kjo lëndë është përcaktuar në kategorinë B (LËNDË KARAKTERIZUESE), për shkak se përmban lëndë karakterizuese për formimin që synon të japë programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike. Logjikisht, lënda "Informatike 3", mund të konsiderohet si 50% (4 kredite ECTS) në kategorinë "B" dhe 50% (4 kredite ECTS) në kategorinë C.

Në këtë mënyrë, arrihet përputhshmëria në përqindje e krediteve sipas kategorive, siç kërkohet nga VKM 41.

Për ta formalizuar, lënda "Informatike 3" parashikohet të ndahet në dy lëndë, ku njëra është e kategorisë B me 4 kredite (ECTS), e detyrueshme, ndërsa tjetra përbëhet nga grup-lëndë me zgjedhje (kategoria C) me 4 kredite (ECTS) në total. Emërtimet e lëndëve të reja evitojnë edhe numrin pas emrit të lëndës.

Megjithatë, kjo ndarje nuk është realizuar pasi, si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi nuk kemi bërë ndryshime në planin mësimor, pa kaluar një fazë të parë vlerësimi të jashtëm.

Përgjigje e GVJ:

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në hartimin e draft-RVJ, ka paraqitur në standardin II.1/kriteri 5 dhe në standardin II.3/kriteri 3, mos përputhshmërinë “formale” të ndarjes në kategoritë e parashikuara në VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar. Kjo pasi edhe arsyetimi i paraqitur nga IAL, por edhe nga shqyrtimi i VKM 41 të modifikuar me VKM 185, datë 25.03.2021, ndarjet e lëndëve në kategori, për këtë lloj profili studimi, nuk janë të përshtatshme. Kjo pasi në VKM-të e sipër cituara, futen në kategorinë “D”, lëndë të formimit informatik, duke i quajtur ato plotësuese apo si ndërdisiplinore duke i futur në kategorinë “C”, lëndë që për këtë program studimi realisht përbëjnë thelbin karakterizues.

Sikurse e kemi shprehur edhe në draft RVJ, devijimi nga ndarja në përqindje të lëndëve mes kategorive, në rastin konkret është formale për vet natyrën e lëndëve që specifikisht për këtë program studimi, mund të jenë njëkohësisht në dy kategori.

Për sa më sipër, vlerësimi i paraqitur në draft raport ndryshon, përkatësisht:

Standardi II.1 / Kriteri 5; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

Standardi II.3 / Kriteri 3; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

2. Komenti i IAL mbi “Aktiviteti formues praktik, sugjerohet që në organizimin e planit mësimor të ketë një lëndë “Praktikë Profesionale” që të zhvillohet pranë institucioneve ose kompanive të lidhura me objektivat e programit të studimit.”

Të vetëdijshëm se zhvillimi i praktikave pranë institucioneve ose kompanive të ndryshme rrit aftësitë dhe kompetencat e studentëve për punësim, jemi në kontakte të vazhdueshme për të lidhur marrëveshje praktike, që të jenë të mjaftueshme për një numër i madh studentësh (çdo vit regjistrohen 100 studentë). Deri në realizimin e këtij objekti, formimi praktik i studentëve realizohet me anë të politikave të nxitjes së tyre për kryerjen e intershipeve në ato kompani, me të cilat kemi marrëveshje, shtimit të detyrave të kursit veçanërisht në lëndët karakterizuese dhe ato ndërdisiplinare. Me përmirësimin e infrastrukturës me mjete laboratorike, janë krijuar kushte për riorganizim të disa lëndëve, ku parashikohet të shtohen orë laboratorike.

Përgjigje e GVJ:

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në hartimin e draft-RVJ, ka paraqitur në standardin I.5/kriteri 4, në standardin II.1/kriteri 6 si dhe në standardin II.4/kriteri 2, mungesën e një lënde “Praktikë profesionale” si të nevojshme për përgatitjen dhe njohjen e studentëve me tregun e punës.

Edhe pse e vlerësojmë shumë pozitive impenjimin e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi për përçimin e dijeve dhe rritjen e vazhdueshme të numrit të bashkëpunimeve me kompani që kanë veprimtari në fushën e kompetencës së studentëve të këtij programi studimi, sugjerimi mbetet i vlefshëm për ta zyrtarizuar bashkëpunimet që kanë në kuadër të planit mësimor.

Numri i studentëve të regjistruar, nuk duhet të bëhet pengesë për ofrimin maksimal të kriterëve dhe standardeve të cilësisë.

Për sa më sipër, komenti i paraqitur nga institucioni, edhe pse i gjykuar pozitivisht nga GVJ, nuk përbën arsyetim të mjaftueshëm për të ndryshuar përmbajtjen e raportit për këtë argument.

Standardi I.5 / kriteri 4; nuk ndryshon

Standardi II.1 / kriteri 6; nuk ndryshon

Standardi II.4 / kriteri 2; nuk ndryshon

3. Komenti i IAL mbi “Mungesën e informacionit mbi ndarjen në kredite ECTS të lëndëve, theksojmë se në planet mësimore dhe Syllabus-et, për çdo lëndë paraqitet numri i krediteve ECTS totale, por jo ndarja e tyre sipas aktiviteteve didaktike (leksione, seminare, laboratore, detyra kursi, projekte etj.).”

Universiteti i Tiranës, njësi e të cilit është Fakulteti i Shkencave të Natyrës, nuk ka aplikuar një ndarje të tillë.

Përgjigje e GVJ:

Grupi i vlerësimit të jashtëm, ka paraqitur në analizën e standardit II.1/kriteri 6, standardit II.3/kriteri 4 si dhe standardit II.4/kriteri 3, mungesën e ndarjes së krediteve të parashikuara për çdo lëndë në aktivitetet përbërëse të saj.

Ndarje që sipas GVJ është e nevojshme jo vetëm për të ndarë qartazi peshën që secili aktivitet didaktik ka në formimin e studentit, por edhe për të kuptuar në nivel institucional mjaftueshmërinë e ambienteve didaktike për secilin aktivitet. Pra me përcaktimin e numrit të krediteve për leksione/seminare/laborator për çdo lëndë, dhe duke ditur numrin e studentëve që frekuentojnë jo vetëm këtë program studimi, por të gjithë programet e studimit që shfrytëzojnë ato ambiente, është e mundur të bëhet edhe një analizë sasiore mbi mjaftueshmërinë e ambienteve, nevojave për ambiente të reja apo për ndryshimin e përdorimit nga ambiente seminari në ambiente laboratorike nëse është e nevojshme.

Gjithashtu, ndarje e krediteve për secilin aktivitet formues brenda lëndës, plotësoh dhe lehtëson konceptin e krediteve ECTS (*European Credit Transfer and Accumulation System*) në rast transferimi studimesh brenda apo jashtë vendit.

GVJ, edhe pse vlerëson se rekomandimi i më sipërm për ndarjen e krediteve brenda çdo lënde qëndron, por gjithashtu vlerëson se njësi bazë (departamenti) përgjegjës për këtë program studimi, ka zbatuar udhëzimet institucionale në hartimin e plan-programeve të lëndëve. Pra edhe pse sugjerimet qëndrojnë, ato nuk janë kompetencë e njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, por duhen vlerësuar në nivel akreditimi institucionale si pjesë e akteve rregullatore të hartuara në nivel Universitetit.

Për sa më sipër, komenti i paraqitur nga institucioni qëndron, dhe vlerësimi i paraqitur në draft raport ndryshon si vijon:

Standardi II.1 / Kriteri 6; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

Standardi II.3 / Kriteri 4; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

Standardi II.4 / Kriteri 3; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

- 4. Komenti i IAL mbi “Në lidhje me personelin akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit, për vitin akademik 2018-2019 evidentohet se stafi PAE ka mbuluar 68.4% të ngarkesës mësimore, 1.6% më pak se parashikimi në aktet rregullatore, ndërsa në vitet pasuese ky mbulim arrin masën 87%.”**

Departamenti i Matematikës së Aplikuar, ka qenë i angazhuar maksimalisht në ofrimin e një programi mësimor cilësor, por edhe në garantimin e një vazhdueshmërie të transferimit të njohurive dhe qëndrueshmërie të stafit akademik, edhe pse të vetëdijshëm se në vitin akademik 2018-2019 departamenti ka angazhuar staf PAE në masën 68.4 % të mbulimit të ngarkesës në tërësi.

Megjithatë, sqarojmë se ngarkesa specifike për çdo student, edhe në këtë vit është në masë më të madhe së 70% me staf PAE. Kjo pasi raporti i mësipërm merr në konsideratë orët totale për të gjitha grupet e leksioneve dhe seminareve.

Nëse i referohemi me një shembull të thjeshtë: një lëndë me një total 60 orë në auditor të ndara me 42 orë leksione në auditor të zhvilluara nga staf PAE, dhe 18 orë seminare të zhvilluara nga staf PAK, nëse është vetëm një grup seminari, raporti është 70% PAE (42/60) dhe 30% PAK (18/60). Në rastin konkret, për këtë program studimi, në atë vit akademik kanë qenë më shumë se një grup seminari, por një grup i vetëm leksioni. Nëse kemi një grup leksioni, por dy grupe seminari për këtë lëndë, si raport i paraqitur në tabelat e RVB, janë 42 orë leksione PAE dhe 18+18 orë seminare PAK duke ndryshuar raportin tashmë 54 % PAE (42/ 78) dhe 46 PAK (36/78). Por secili student, ka ndjekur leksionet me staf PAE dhe seminarin përkatës me staf PAK, pra, edhe në këtë rast, secili student, ka ndjekur aktivitetin didaktik në raportin 70% PAE dhe 30 % PAK. Referuar edhe VKM 41 dhe standardeve të cilësisë, flitet për mbulimin e orëve për të njëjtët studentë në masën së paku 70% nga PAE.

Megjithatë departamenti, është angazhuar maksimalisht për qëndrueshmërinë e stafit dhe rritjen e tij në funksion të cilësisë, sikurse evidentohet edhe nga GVJ për vitet akademike në vijim, që ngarkesa në total është mbi 70%, madje për çdo student, ky raport është më i lartë, pasi numri i grupeve mësimore është mbi një.

Përgjigje e GVJ:

Grupi i vlerësimit të jashtëm, ka paraqitur në analizën e standardit II.5/kriteri 1 si dhe të standardit IV.2/kriteri 4, angazhimin total në përqindje të stafit PAE dhe PAK në këtë program studimi për katër vite akademike (2018-2019 deri në 2021-2022).

Arsyetimi i paraqitur nga institucioni qëndron dhe është në përputhje me aktet rregullatore në fuqi, ku efektivisht ngarkesa mësimore në minimumin e ndarjes PAE/PAK në 70/30 është për student dhe jo për tërësinë e programit.

GVJ, në analizën e të dhënave tabelare, të paraqitura për vlerësimin e jashtëm, nuk e kishte të plotë këtë informacion për të gjykuar mbi fenomenin global të mbulimit të ngarkesës për një vit akademik në raportin 68.4%/31.6%. Megjithatë, arsyetimi i paraqitur nga institucioni konfirmohet edhe me numrin e grupeve mësimore të paraqitura në tabelat në RVB, si dhe me qëndrueshmërinë e stafit PAE të përfshirë në këtë program studimi.

Për sa më sipër, komenti i paraqitur nga institucioni qëndron, dhe vlerësimi i paraqitur në draft raport ndryshon si vijon:

Standardi II.5 / Kriteri 1; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

Standardi IV.2 / Kriteri 4; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

5. Komenti i IAL mbi “Në lidhje me përmbajtjen e Syllabus-eve, janë evidentuar pasaktësi teknike në paraqitjen e numrit të orëve në auditor dhe orëve individuale të studentit.”

Bazuar në VKM Nr. 41 dhe në sugjerimet e përcjella nga GVJ, janë bërë saktësimet e nevojshme për vitin akademik 2022-2023.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Syllabus-et e miratuara për vitin akademik 2022-2023, ku të gjitha rekomandimet e përcjella në draft-raport janë marrë në konsideratë.

Përgjigje e GVJ:

Grupi i vlerësimit të jashtëm, ka paraqitur në analizën e standardit II.1/kriteri 6, standardit II.3/kriteri 4 si dhe të standardit II.3/kriteri 7, pasaktësitë e vërejtura në hartimin e plan-programeve të lëndëve. Pasaktësi të cilat janë formale për institucionin, por duke qenë syllabusi një dokument shumë i rëndësishëm për përshkrimin e aktiviteteve formuese, dhe qa më tepër i nevojshëm për studentët në rast të transferimit të studimeve në një institucion tjetër të arsimit të lartë, plotësimi i saktë i tyre nga institucioni, është i nevojshëm dhe i domosdoshëm.

Nga analiza e syllabuseve të paraqitura si dokumentacion shtesë, vërejmë se institucioni i ka plotësuar ato me saktësi sipas formatit dhe informacionit të parashikuara në aktet rregullatore të Universitetit të Tiranës, duke qenë edhe formati i unifikuar në rang universiteti.

Edhe pse ne si GVJ, gjykojmë se formati i syllabusit duhet të pasurohet me informacione të tjera sikurse janë ato të paraqitura në komentin 3 më sipër, ato nuk janë pjesë e kompetencës së njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, dhe gjykojmë se duhet të jenë pjesë e vlerësimit institucional dhe jo të programit të studimit.

Për sa më sipër, komenti i paraqitur nga institucioni merret parasysht në hartimin e raportit përfundimtar dhe vlerësimi i paraqitur në draft raport ndryshon si vijon:

Standardi II.1 / Kriteri 6; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

Standardi II.3 / Kriteri 4; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

Standardi II.3 / Kriteri 7; ndryshon duke shtuar referencë analizën e më sipërme

Në tërësi të komenteve të paraqitura nga institucioni, dokumentacionit shtesë dhe analizës tërësore të standardit II dhe kritereve përbërëse, ndryshon si vijon:

- Standardi II.1 ndryshon nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”
- Standardi II.3 ndryshon nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”

Si dhe në tërësi vlerësimi i standardit II ndryshon nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”

Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se programi i studimeve i Ciklit të parë Bachelor (Bsc) në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” i ofruar nga i Departamenti Matematikës së Aplikuar (DMA), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program bashkëkohor dhe koherent ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studentëve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti (<i>Evidenca 1.1</i>). Fusha e programit të studimit është në përputhje me misionin, strategjinë e Universitetit të Tiranës si dhe strategjisë kombëtare të zhvillimit të teknologjisë së informacionit (<i>Evidenca 1.9</i>).			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i statutit të Universitetit të Tiranës (<i>Evidenca 1.1</i>) dhe Planit Strategjik të tij (<i>Evidenca 1.2</i>) GVJ vlerëson se programet e studimit, përfshirë programin Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ndër të tjera Universiteti i Tiranës synon t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira të dijes dhe të shkencës si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare (<i>Evidenca 1.9</i>).			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bsc “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit (<i>Evidenca 1.2</i>), si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Informatikës dhe matematikës së zbatuar.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” i përgjigjet kërkesave të kohës për rritjen e rolit të teknologjisë së informacionit, matematikës së aplikuar dhe informatikës në tërësi, në të gjithë aspektet e jetës së përditshme dhe është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit Çka është e përcaktuar edhe në planin e zhvillimit strategjik të këtij programi (<i>Evidenca 1.4</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe informatike” është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit (<i>Evidenca 1.2</i>) i cili ka si objektiva strategjik, midis të tjerash, cilësinë dhe performancën akademike, kërkimin shkencor dhe inovacionin si dhe reformën kurrikulare në dy drejtime rishikimi i kurrikulave ekzistuese dhe hapja e kurrikulave të reja. Përbushja e misionit të Universitetit të Tiranës (UT) planifikohet të realizohet dhe duke siguruar shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit (<i>Evidenca 1.9</i>).			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti i UT (<i>Evidenca 1.1</i>) përcakton qartë drejtimit prioritar akademike të tij. Një nga drejtimit prioritar akademike të UT është në fushën e teknologjisë së informacionit dhe drejtimeve të lidhura me të. Fusha e studimit në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” përputhet me atë të strategjisë së zhvillimit institucional (<i>Evidenca 1.2</i>). Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Matematikës së Aplikuar, që kanë në përgjegjësi realizimin e programit të studimit Bsc në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”, koordinonjë me efikasitet progresin e tyre me Planin Strategjik të Institucionit dhe me rregulloret specifike të tyre (<i>Evidenca 1.4</i>).			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” sigurohet në përputhje me fushat akademike dhe orientimet e institucionit Universiteti të Tiranës (UT). Institucioni, i mbështetur gjithashtu në disa Strategji Kombëtare, ka një nga objektivat kryesore ofrimin e programeve të studimit cilësore në fushën e teknologjisë së informacionit, sisteme informatike, atë të përpunimit dhe të transmetimit dixhital të informacionit, matematikës së aplikuar etj. Në strategjinë e tij (<i>Evidenca 1.2</i>), UT ka përcaktuar qartë objektivat në planin afatgjatë të zhvillimit të tij, të cilat janë kërkesa bashkëkohore si për stafin akademik ashtu edhe kërkesa për brezin e ri të specialisteve në këto fusha. Ky programi studimi i përket nivelit 6 (bachelor) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë objektivat mbi aftësimin e studentëve, përfshirjen e kompetencave profesionale, aftësive dhe njohurive që studentët duhet të fitojnë deri në fund të programit të studimit, duke karakterizuar profilin e programit. Organizimi i këtij programi studimi është i fokusuar në pesë objektivate primare si vijon (<i>Evidenca 1.4, Evidenca 1.6, Evidenca 2.2</i>):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkimi Shkencor <ul style="list-style-type: none"> - Inkurajimi i publikimeve nga stafi akademik - Organizimi i konferencave ndërkombëtare - Pjesëmarrje e stafit në konferenca - Pjesëmarrje në projekte 2. Rritja e cilësisë në mësimdhënie <ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i stafit dhe rritja e punës kërkimore shkencore - Rekrutimi i pedagogëve të kualifikuar - Zhvillim i programeve për shkëmbim stafi dhe studentësh - Zhvillimi i kurrikulave mësimore - Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse për studentët 3. Orientimi drejt sipërmarrjes <ul style="list-style-type: none"> - Transformimi i njohurive në projekte - Rritja e aktiviteteve sipërmarrje-akademi 4. Rritja e kontributit në komunitet <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete komunitare, bamirësie, kulturore dhe sportive, sociale 5. Infrastruktura e mësimdhënies <ul style="list-style-type: none"> - Pasurimi i infrastrukturës në ndihmë të mësimdhënies - Pasurimi i bibliotekës me botime të reja. <p>Programi i studimit ofron në përgjithësi të gjitha aftësitë dhe njohuritë që organizohen sipas skemës së llojit të lëndëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, duke shfrytëzuar modele të programeve të ngjashme të universiteteve perëndimore, duke synuar në përgatitjen e një brezi të specialisteve në fushën e informatikës, matematikës së zbatuar por dhe programues duke synuar në një fushë më të gjerë të lëndëve që mund të trajtohen në të ardhmen (<i>Evidenca 2.1, Evidenca 2.2</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes DVV, në raportin e përgatitur nga UT në vitin 2018 (<i>Evidenca 1.9</i>), del qartë kërkesa e madhe në vend për specialist në fushën e teknologjisë së informacionit dhe IT-së, inxhinierisë kompjuterike, të inxhinierisë software dhe të sistemeve digjitale të përpunimit dhe transmetimit të informacionit.</p> <p>https://www.unitir.edu.al/images/Vendimi_i_SA_nr.4_date_22.02.18.pdf</p> <p>https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/04/Kerkim-tregu-2018.pdf&download=false&print=false&openfile=false</p>

<p>dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në raportet e realizuar në rang fakulteti (<i>Evidenca 1.26a, Evidenca 1.26b, Evidenca 1.26c</i>), dhe atë rreth studimit të tregut të punës (<i>Evidenca 1.9</i>), njësia bazë, Departamenti i Matematikës së Aplikuar, ka argumentuar ndryshimet në planin mësimor deri në 20% në programin Bachelor në IMI . Këtu janë riorganizuar lëndët e fushës së Informatikës që zhvillohen në dy vitet e para, me qëllim që formimi i studentëve në këtë fushë t'i përshtatet më mirë risive më të fundit në funksion të profesionit që ata do të marrin dhe përgatitjes më të mirë për tregun e punës ose për studimet e mëtejshme në programet e ciklit të dytë. Bazuar në këto dokumente jepen rezultatet e nxjerra nga interpretimi i të dhënave, por nuk jepen burime të të dhënave mënyrën e mbledhjes se tyre dhe besueshmëria.</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bsc në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve (<i>Evidenca 1.6</i>). Qëllimi i programit, është të sigurojë përgatitjen e specialistëve në fushën e teknologjisë se informacionit, informatikës dhe matematikës së aplikuar, bazuar në programet më të përparuar të kohës. Programi u jep studentëve koncepte themelore të komunikimit dhe transmetimit të informacionit dhe përmes njohjes së veçorive kryesore të përpunimit të sistemeve të informacionit, si në harduer, ashtu edhe në softuer (<i>Evidenca 2.1</i>). Në veçanti, synohen njohuritë që mbulojnë bazat e arkitekturës së kompjuterëve dhe sistemeve kompjuterike, çështje që lidhen me projektin dhe integrimin e pajisjeve kompjuterike dhe softuerëve, me njohuri të thelluara të sistemeve operative, gjuhëve programuese, teknikave dhe metodave të inxhinierisë softuerike, parimet dhe teknologji për modelim, modelim dhe menaxhim të bazës së të dhënave etj.</p> <p>Përmbajtja e programit të studimit i përmbahet kërkesave të kohës dhe të tregut në vend dhe rajonit (<i>Evidenca 2.2</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike</p>	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që FSHN/ UT ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”.</p> <p>Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, i cili ka 8 (tetë) departamente dhe 1 (një) qendër kërkimore shkencore :</p>

për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.

1. Departamenti i Informatikës
2. Departamenti i Matematikës
3. **Departamenti i Matematikës së Aplikuar**
4. Departamenti i Fizikës
5. Departamenti i Kimisë
6. Departamenti i Kimisë Industriale
7. Departamenti i Biologjisë
8. Departamenti i Bioteknologjisë
9. QKFF (Qendra Kombëtare e Studimit të Florës dhe Faunës Shqiptare)

Burimet njerëzore: Stafit akademik bazuar në CV-të rezulton me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të Inxhinierisë Matematike dhe Informatike, dhe në tërësi të Shkencave të Natyrës (*Evidenca 2.6, Evidenca 1.14, Evidenca 1.15, Evidenca 1.16b*).

Nga të dhënat që jepen në DVV, rezulton numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të Teknologjisë së Informacionit; Inxhinierisë Informatike; Matematike dhe Ekonomike.

Personeli Akademik Efektiv (*Evidenca 2.4, Evidenca 2.5, Evidenca 1.16a*) (PAE) në nivel fakulteti (176 pedagogë PAE) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë (Të dhëna të përpunuara nga gjetjet në DVV, viti akademik 2021-2022):

- | | |
|----------------|----|
| 1. Prof. Dr. | 32 |
| 2. Prof. Asoc. | 41 |
| 3. Dr/PhD | 80 |
| 4. Dr. Proc. | 0 |
| 5. Msc | 23 |

Personeli Akademik me kohë të pjesshme me kontrate (PAK) në nivel fakulteti (122 pedagogë PAE), gjithashtu ka edhe 46 personel akademik ndihmës akademik (*Evidenca tabelat ASCAL*).

Në Departamentin e Matematikës së Aplikuar, i cili është përgjegjës për këtë programin e studimit, në vitin akademik 2021-2022 janë 12 staf akademik PAE dhe 11 staf akademik PAK të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi	Nr. staf akademik PAE	Nr. Staf akademik PAK
Prof. Dr.	1	3
Prof. Asoc.	3	2
Dr./PhD	7	1
Dr. Proces	0	0
Msc.	1	5
Total	12	11

Bazuar në CV e stafit akademik rezulton se ai ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë.

Burimet Infrastrukturore: Auditore, Klasa për leksione dhe seminare, Laboratore për praktikë profesionale, Laboratorë informatike, Bibliotekë, Mjedise për fotokopjim/librari, Zyra për

	informimin e studentëve, Zyra për stafin, Sallat e mbledhjeve, Mjedise për personelin e shërbimit, etj Shërbime IT: (Shërbime Mësimdhënie Edu4school, Google Services, Go to Meeting, Google classroom, MS Teams etj). Në shërbimet IT të ofruara, është edhe mbulimi me sinjal WiFi në pjesën më të madhe të ambienteve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ofron programe studimi në fushën e Matematikës, Matematikës së aplikuar, Informatikës dhe fushave të lidhura me to (<i>Evidenca 5.7</i>). Departamenti i Matematikës së Aplikuar ofron programe studimi në të tre ciklet sipas nivelit 6, 7 dhe 8 të kornizës kombëtare të kualifikimeve, dhe përkatësisht (<i>Evidenca 1.3</i>):			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<ul style="list-style-type: none"> - Bachelor në Inxhinier Matematike dhe Informatike - Master i Profesional në Inxhinieri Matematike dhe Informatike - Master i Shkencave në Inxhinier Matematike dhe Informatike - Doktraturë në Metodatat probabilitare, statistike dhe metodatat e analizës numerike - Doktraturë në Kërkime operacionale <p>GVJ konstaton se fusha e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike, është në përputhje me fushën akademik dhe kërkimore të Departamentit të Matematikës së Aplikuar është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (<i>Evidenca 1.4</i>). Për sa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar RVB-së dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi nuk është përcaktuar akoma nga institucioni. Megjithatë, nga analiza e programeve të lëndëve, ato janë në përputhje me objektivat e këtij programi studimi dhe të ngjashme me ato të institucioneve të tjera kombëtare që ofrojnë programe studimi analoge (<i>Evidenca 1.4</i>).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësave e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Ndarja e detyrave mes njësave dhe personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren tij dhe në atë të njësisë bazë. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Matematikës së Aplikuar, menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare me 180 kredite (<i>Evidenca 1.26c, Evidenca 3.8</i>). Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (Njësia e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokoli, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë etj.) dhe departamentet e tjera brenda Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe në tërësi në Universitetin e Tiranës që rrit efektivitetin e këtij programi studimi (<i>Evidenca 2.4, v2.5, Evidenca 1.16a</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UT, dhe në veçanti Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private dhe institucione të tjera shtetërore (<i>Evidenca 1.29, Evidenca 3.30a, Evidenca 3.30b</i>).</p> <p>Nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën përgjegjëse për marrëdhëniet më jashtë, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja apo me kompani biznesi. Gjithashtu vihet re edhe rritja e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ gjatë takimit në institucioni nuk vuri re një analizë të mirëfilltë periodike për programin e studimit apo hartimin e raporteve analitike për të analizuar marrëveshjet e bashkëpunimit në fuqi (<i>Evidenca 6.13</i>).</p> <p>Departamenti i Matematikës së Aplikuar ka hartuar raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve (<i>evidencë 6.7</i>). Këto marrëveshje dhe që kanë dhënë efekt janë në kuadër të programit Erasmus ku disa pedagogë të Departamentit të Matematikës së Aplikuar kanë përftuar bursa të tilla (<i>evidencë 1.29, evidencë 4.12</i>)). Në kuadër të këtyre marrëveshjeve ka patur edhe shkëmbime eksperience duke ftuar edhe profesorë të huaj për leksione të hapura për personelin akademik dhe studentët. (<i>evidencë 3.10</i>).</p> <p>Njësia kryesore, dhe në veçanti Departamenti i Matematikës së Aplikuar, përdor si raporte periodike, ato të hartuara nga njësiti përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, bazuar në anketimet e realizuara me studentët (<i>Evidenca 6.15</i>). Por në këto anketime, nuk ka informacione të mjaftueshme për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe efikasitetit të tyre në funksion të përçimit të dijeve.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në planin mësimor në tre vitet e fundit akademike 2018-2021 nuk është parashikuar të zhvillohet ndonjë lende apo modul praktike profesionale (<i>Evidenca 1.6</i>).</p> <p>Në planin mësimor është parashikuar një lëndë me 5 kredite ECTS, "Njohje me Profesionin" e cila udhëzon studentët drejt tregut të punës, por nuk parashikon praktikë profesionale (<i>Evidenca 1.6</i>). Njësia kryesore FSHN dhe njësia bazë DI kane lidhur një numër marrëveshjesh për realizimin e bashkëpunimeve, por për këtë program studimi nuk evidentohen që studentët të kenë kryer praktika profesionale, përveç rasteve individuale të studentëve (<i>Evidenca 1.29</i>).</p> <p><i>Rekomandohet që institucioni të beje përpjekje për fuqizimin e bashkëpunimeve me aktor të ndryshëm të fushës në teknologji informacioni dhe sa me shpejte të përfshije në planin mësimor për lëndën e praktikës profesionale.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në DVV, RVB dhe evidentimin përgjatë vizitës në institucion rezulton se në nivel njësie kryesore, dhe në veçanti nga Departamenti i Matematikës së Aplikuar, me një periudë çdo dy vite, organizohet konferenca shkencore RTA-CSIT. Në këtë konferencë ftohen të marrin pjesë studente dhe të diplomuar jo vetëm nga programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Matematikës së Aplikuar, por edhe nga ai i njësive të tjera bazë në FSHN sikurse është ai i Matematikës së Aplikuar.</p> <p>Nga njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, janë realizuar edhe disa leksione të hapura të cilat kanë në fokus trajnimin e vazhduar jo vetëm të studentëve por edhe të stafit (<i>Evidenca 1.29, Evidenca 3.10, Evidenca 3.11, Evidenca 3.12</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PRORAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>), në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ai ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” përmban 180 ECTS në total me një shpërndarje prej 30 ECTS në semestër. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar (<i>Evidenca 1.6</i>).</p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/ detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi mësimor i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, Datë 04.03.2010, “Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare”, i ndryshuar. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Më poshtë janë specifikuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët në programin Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike do të zotërojnë sipas Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (<i>Evidenca 1.4</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> – Specialist në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit – Specialist në IT në institucione publike dhe private – Programues software – Specialist rrjetash kompjuterike – Menaxher projektsh IT – Menaxher i sistemeve të informacionit
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët bazë teorikë të nevojshëm për përgatitjen e studentëve me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushat e teknologjisë së informacionit, teknologjive elektronike dhe komunikimit dixhital, si dhe në disiplina mbështetëse (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>). Departamenti i Matematikës së Aplikuar, synon mbajtjen e kontakteve me tregun e punës dhe përshtatjen me kërkesat e tij, si dhe në ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve.</p>

	<p>Në këtë mënyrë, si dhe nëpërmjet ndjekjes së zhvillimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, synohet të përshtatet e përsoset kurrikula e këtij programi studimi.</p>																				
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të qarta të cilat pasqyrohen tek syllabuset e çdo lënde të cilat janë në përputhje me ato të programit (<i>Evidenca 2.1</i>).</p> <p>Programi i studimit Bachelor, synon ta pajisë studentin me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; - Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; - Formim qytetar të përgjithshëm; - Aftësi bazë për punë kërkimore; - Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; - Aftësim për promovim personal; <p>Përgatitja gjatë periudhës tre vjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet në nivelin e dytë të studimeve. Kërkesat e tregut të punës për specialistë që diplomohen në këtë profil janë në rritje, ndaj programi i studimit synon plotësimin e tyre me të diplomuar cilësorë.</p> <p>Megjithatë, në planet mësimore, vihet re një numër i ulët i krediteve dhe orëve përkatëse për aktivitetet laboratorike. Në veçanti, në planin mësimor, janë parashikuar vetëm 3 kredite ECTS për aktivitete laboratorike. Pra vetëm 1.7% e krediteve janë të dedikuara për aktivitete laboratorike (<i>Evidenca 1.6</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, takimin me organet drejtuese, stafin akademik dhe studentët, u qartësua se një pjesë e seminareve zhvillohen në ambiente laboratorike, ku praktikohen njohuritë e marra. Megjithatë, nuk ka një ndarje të mirëfilltë të orëve laboratorike të dedikuara për këtë program studimi (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>).</p> <p>Kjo mangësi, vështirëson edhe vlerësimin e treguesve sasior të mjaftueshmërisë së ambienteve laboratorike në tërësi.</p> <p><i>Ne si GVJ, sugjerojmë që të rritet numri i orëve laboratorike, sidomos për lëndë të kategorisë B (Lëndë karakterizuese) dhe ato të kategorisë C (Lëndë ndërdisiplinore/integruese).</i></p>																				
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Bazuar në ndarjen e veprimtarive në kategori formuese, institucioni ka parashikuar një ndarje për këtë program studimi si më poshtë vijon (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>):</p> <table border="1" data-bbox="630 1635 1356 1926"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi</th> <th>IAL</th> <th>Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë Bazë</td> <td>20 %</td> <td>15 – 20 %</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>52.2 %</td> <td>50 – 55 %</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td> <td>10 %</td> <td>12 – 15 %</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese</td> <td>14.4 %</td> <td>10 – 15 %</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Tipi	IAL	Standardi	A	Lëndë Bazë	20 %	15 – 20 %	B	Lëndë karakterizuese	52.2 %	50 – 55 %	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	10 %	12 – 15 %	D	Lëndë plotësuese	14.4 %	10 – 15 %
Kategoria	Tipi	IAL	Standardi																		
A	Lëndë Bazë	20 %	15 – 20 %																		
B	Lëndë karakterizuese	52.2 %	50 – 55 %																		
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	10 %	12 – 15 %																		
D	Lëndë plotësuese	14.4 %	10 – 15 %																		

	E	Detyrime përmbyllëse	3.3 %	3 – 5 %
<p>Megjithëse ndarja e lëndëve sipas kategorive të paraqitur në planin mësimor është në tërësi konform VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në të nuk është parashikuar një lëndë “praktikë profesionale” në kategorinë “D”. Gjithashtu, kategoria “C”, lëndë ndërdisiplinore/ integruese, është parashikuar me 18 kredite ECTS (10%), e cila është më pak se minimumi i parashikuar nga aktete rregullatore, e cila kërkon së paku 21.6 kredite ECTS (12%). Megjithatë, kjo mospërputhje, është formale, pasi lëndët e parashikuara në kategorinë “C” janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në Informatikë - Strukturë të dhënash në C++ - Algoritmikë dhe programim JAVA - Sisteme Shfrytëzimi <p>Ndërsa në kategorinë “B” ka lëndë që logjikisht mund të jenë pjesë edhe në kategorinë “B” ose/edhe në atë “C”, sikurse është lënda “Informatikë 3”. Pra, edhe pse formalisht, numri i krediteve të parashikuara në kategorinë “C” nuk është i plotë, njohuritë e kësaj kategorie, janë të parashikuara të plota në planin mësimor.</p> <p><u>Nga shqyrtimi i VKM 41 të modifikuar me VKM 185, datë 25.03.2021, ndarjet e lëndëve në kategori, për këtë lloj profili studimi, nuk janë të përshtatshme. Kjo pasi në VKM-të e sipër cituara, futen në kategorinë “D”, lëndë të formimit informatik, duke i quajtur ato plotësuese apo si ndërdisiplinore duke i futur në kategorinë “C”, lëndë që për këtë program studimi realisht përbëjnë thelbin karakterizues.</u></p> <p><u>Sikurse e kemi shprehur edhe në draft RVJ, devijimi nga ndarja në përqindje të lëndëve mes kategorive, në rastin konkret është formale për vet natyrën e lëndëve që specifikisht për këtë program studimi, mund të jenë njëkohësisht në dy kategori.</u></p> <p>Kategoritë e lëndëve Bazë dhe atyre karakterizuese, “A” + “B” është 72.2 % në përputhje me të njëjtën VKM, e cila saktëson se shumica e këtyre dy kategorive duhet të jetë jo më pak se 70% (Evidenca 1.6).</p> <p>Programi gjithashtu, ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, të cilat janë kryesisht leksione dhe seminare, <i>por pa specifikuar laboratorë</i>, që në këtë program studimi janë kryesisht laborator kompjuterik (Evidenca 1.6, Evidenca 2.1).</p> <p><i>GVJ sugjeron shtimin e orëve laboratorike në veprimtaritë formuese të programit të studimit.</i></p> <p><i>Nga GVJ vlerësohet si mangësi në ofrimin e një programi cilësor, mungesa e praktikës profesionale pranë institucioneve apo kompanive të lidhura me objektivat e këtij programi studimi. Për të cilën, sugjerojmë shtimin e saj në planin mësimor.</i></p>				
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke</p>	<p>Bazuar në planin mësimor por edhe në plan programet e lëndëve, vërehet se secila lëndë ka të përcaktuar qartë objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët si në auditor ashtu edhe punim</p>			

grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

individual. Megjithatë, vërehet se institucioni nuk përdor një metrikë të njëjtë në vlerësimin e ngarkesës në auditor për kredit për lëndë, së paku për lëndë të të njëjtës kategori.

Nëse i referohemi planit mësimor të paraqitur në **Evidencë 1.6** në RVB, duke marrë si shembull lëndë të kategorisë B, në planet mësimore disa lëndë paraqiten me 9 kredite ECTS në total të ndara në mënyrë të barabartë mes leksioneve dhe seminareve (50/50%), duke patur një ngarkesë totale prej 90 orë në auditor, pra 10 orë/1 kredit ECTS në auditor.

Për disa lëndë të tjera, po të kësaj kategorie, me 8 kredite ECTS, po me ndarje të barabartë mes orëve të leksioneve dhe seminareve (50% me 50%), paraqiten me një ngarkesë totale në auditor prej 88 orësh, pra 11 orë/1 ECTS.

Në mënyrë të ngjashme vërehet edhe për lëndë të kategorive të tjera, si ato të kategorisë D, ku një lëndë paraqitet me një ngarkesë në auditor prej 45 orë/6 ECTS (pra 7.5 orë/1 ECTS) dhe një tjetër me 58 orë/5 ECTS (11.6 orë/ECTS). Për shembujt më sipër, si për kategorinë B, ashtu edhe për atë D të sipër cituar, kanë të parashikuar një numër të barabartë orësh midis leksioneve dhe seminareve.

Në planet mësimore (**Evidenca 1.6**), ka disa mangësi kundrejt atyre të kërkuara nga VKM 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar për "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

Në planet mësimore nuk paraqitet numri total i krediteve ECTS për lëndën dhe as ndarja e tyre në aktivitete formuese. Pra nuk ka një informacion se sa kredite janë të parashikuara për leksione, sa për seminare, laboratorë apo detyra kursi.

GVJ, edhe pse vlerëson se rekomandimi i më sipërm për ndarjen e krediteve brenda çdo lënde qëndron, por gjithashtu vlerëson se njësia bazë (departamenti) përgjegjës për këtë program studimi, ka zbatuar udhëzimet institucionale në hartimin e plan-programeve të lëndëve. Pra edhe pse sugjerimet qëndrojnë, ato nuk janë kompetencë e njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, por duhen vlerësuar në nivel akreditimi institucionale si pjesë e akteve rregulatore të hartuara në nivel Universitetit.

Në Syllabuset (**Evidenca 2.1**), gjithashtu, paraqitet përgjegjës i lëndës, por që në VKM 41 duhet të paraqitet titullari si emërtim.

Në paraqitjen e disa prej syllabuseve, në emërtimion e "Përgjegjës i lëndës", duke nënkuptuar kështu titullarin e saj, paraqitet personel akademik me kualifikimin "Master i Shkencave", i cili nuk është në përputhje me Nenin 59 të Ligjit 80/2015 për arsimin e lartë.

Në disa prej syllabuseve të lëndëve për vitin akademik 2020-2021, vërehet që ka pasaktësi në numrin total të orëve në auditor + atyre për studim individual, numër që nuk përputhet me ngarkesën që duhet të ketë lënda, referuar krediteve ECTS të paraqitura në planin mësimor. Për sa më sipër, institucioni, mbasi analizoi draft-raportin, paraqiti si dokumentacion shtes, syllabuset e lëndëve për vitin akademik 2022-2023.

Nga analiza e syllabuseve të paraqitura si dokumentacion shtesë, vërejmë se institucioni i ka plotësuar ato me saktësi sipas formatit dhe informacionit të parashikuara në aktet rregullatore të Universitetit të Tiranës, duke qenë edhe formati i unifikuar në rang universiteti.

Edhe pse ne si GVJ, gjykojmë se formati i syllabusit duhet të pasurohet me informacione të tjera sikurse janë ato të paraqitura në komentin 3 më sipër, ato nuk janë pjesë e kompetencës së njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, dhe gjykojmë se duhet të jenë pjesë e vlerësimit institucional dhe jo të programit të studimit.

Gjithashtu, në plan-programet e lëndëve për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 nuk paraqitet ngarkesa në kreditet për aktivitetet formuese të lëndëve, por vetëm orët që ato parashikojnë në auditor. Pra jepen kreditet totale të lëndëve pa i ndarë ato në kredite për leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj.

Në këtë mënyrë është e vështirë vlerësimi i parametrave cilësor të aktiviteteve formuese për secilën lëndë.

GVJ, edhe pse vlerëson se rekomandimi i më sipërm për ndarjen e krediteve brenda çdo lënde qëndron, por gjithashtu vlerëson se njësia bazë (departamenti) përgjegjës për këtë program studimi, ka zbatuar udhëzimet institucionale në hartimin e plan-programeve të lëndëve. Pra edhe pse sugjerimet qëndrojnë, ato nuk janë kompetencë e njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, por duhen vlerësuar në nivel akreditimi institucionale si pjesë e akteve rregullatore të hartuara në nivel Universitetit.

Në planet mësimore por edhe në programet e lëndëve, *ka mungesë të parashikimeve për aktivitet laboratorik.*

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik i cili u pyet rreth këtij argumenti, u sqarua se pavarësisht se në plan-programet e lëndëve, nuk është parashikuar në zë të veçantë aktiviteti laboratorik, zhvillimi i tyre është i integruar me pjesën e ushtrimeve ku për lëndë karakterizuese zhvillohet në laboratorët e informatikës. Kjo bën të mundur që ushtrimet e parashikuara për lëndën, përveç trajtimit teorik të mirëfilltë, zhvillohen si zgjidhje kompjuterike nga studentët gjatë këtyre seancave ushtrimore.

Edhe pse GVJ e konfirmoi pohimet e më sipërme edhe gjatë takimit me student të këtij programi studimi, *sugjeron institucionin të përdori një ndarje formale të aktiviteteve didaktike duke parashikuar edhe laboratorët përkatëse. Në këtë mënyrë është e mundur të vlerësohet edhe nga ana sasiore dhe cilësore zhvillimi i tyre në funksion të përcimit të njohurive.*

Plotësimi i syllabuseve të lëndëve (*Evidenca 2.1*), së bashku me përcaktimet e krediteve ECTS për secilin aktivitet formues, janë të nevojshme, sidomos për studentët të cilët, në rast të transferimeve të studimeve të tyre brenda apo jashtë vendit, paraqesin informacionin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për vlerësimin e njohurive të marra prej tyre.

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Matematikës së Aplikuar, i cili është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike" (<i>Evidenca 1.12</i>), në vitin akademik 2021-2022, ka në përbërjen e tij 12 (dymbëdhjetë) anëtar, nga të cilët, 1 me titullin Prof. Dr, 3 me titullin Prof. Asoc., 7 me kualifikimin Dr., dhe një me kualifikimin Msc (<i>Evidenca RVB – Tabela IMI</i>). Përbërja e kësaj njësie bazë, është në përputhje me nenin 25 të ligjit 80/2015, sikurse edhe për njësitë e tjera bazë që përbëjnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës përbëhet i cili përbëhet nga 8 njësi bazë plus 1 qendër kërkimore shkencore konform nenit 23 të ligjit 80/2015.</p> <p>Edhe institucioni i arsimit të lartë, Universiteti i Tiranës, është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27/10/2018 për katër vite akademike deri më 26.10.2022</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB, Departamenti i Matematikës së Aplikuar, në përputhje me objektivat e tij për realizimin me sukses të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike" ka të përcaktuar objektivat e Koordinatorit të Programit të studimit. (<i>Evidenca 1.20</i>).</p> <p>Roli i tij është i përcaktuar në rregulloren e njësisë bazë (<i>Evidenca 1.28</i>). Koordinator për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike" është caktuar konform Rregullores së Programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Shkencave të Natyrorës si dhe njësia bazë Departamenti i Matematikës së Aplikuar përgjegjëse për programin e studimit, përbushin detyrimet minimale për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Çdo departament kanë mbi 7 pedagog me kohë të plotë nga të cilët të paktën tre janë me grada dhe tituj akademike bazuar në dokumentacionin sipas dosjes RVB (<i>Evidenca 1.12, RVB-Tabela IMI</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e</p>	<p>Në total, njësia kryesore ka në përbërjen e saj 176 anëtar, personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 32 me titull "Profesor", 41 me titull "Profesor i Asociuar", 80 me gradën shkencore "Doktor", dhe 23 me kualifikimin "Master i Shkencave" ku një pjesë prej tyre janë</p>

kualifikimit të personelit akademik.	<p>student të shkollave të doktoratës (<i>Evidenca 2.5, Evidenca 2.4, Evidenca 1.16a</i>).</p> <p>Njësia kryesore ku programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” zhvillohet, ka të angazhuar për këtë program staf akademik PAE dhe PAK në vitin akademik 2021-2022 në përputhje me kualifikimet e nevojshme në lëndët që mbulojnë (<i>Evidenca 1.16b, Evidenca 2.25, Evidenca 2.6</i>):</p> <p>Nga sa më sipër, njësia bazë dhe ajo kryesore, përmbushin kriteret ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Gjithashtu, vihet re edhe bashkëpunimi midisi njësive bazë për mbulimin e ngarkesës akademike me staf akademik specifik sipas formimit të lëndëve dhe stafit akademik përkatës (<i>Evidenca 1.16b, Evidenca 2.25, Evidenca 2.6</i>)</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Në përbërjen e njësisë bazë, Departamenti i Matematikës së Aplikuar është edhe një personel ndihmës akademik, i cili angazhohet në mbështetjen e aktiviteteve laboratorike në funksion të këtij programi studimi (<i>Evidenca RVB-Tabela IMI</i>). Edhe pse në planet mësimore nuk janë detajuar orët e ngarkesës laboratorike apo të praktikave, sikurse u konfirmua gjatë vizitës në institucion, ato zhvillohen së bashku me aktivitetet e ushtrimeve dhe kur është e nevojshme, asistohen edhe nga personeli ndihmës akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Matematikës së Aplikuar disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren e programit mësimor (<i>Evidenca 2.2, Evidenca 1.3</i>), syllabuset (<i>Evidenca 2.1</i>), orarin, Ngarkesën e stafit akademik etj. Dosja e plotë e çdo viti mbahet në departamentin përkatës (<i>Evidenca 1.3, Evidenca 2.2</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”, është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 29 lëndë të ndara sipas 3 viteve (11 lëndë në vitin e parë; 10 lëndë në vitin e dytë dhe 8 lëndë në vitin e tretë. Në vitin e tretë është parashikuar edhe provimi i diplomës me 6 kredite ECTS (<i>Evidenca 1.6</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë</p>	

e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.

Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi si në vijim (*Evidenca 1.6, Evidenca 2.1, Tabela RVB-IMI*):

Kategoria	Tipi	IAL	Standardi
A	Lëndë Bazë	20 %	15 – 20 %
B	Lëndë karakterizuese	52.2 %	50 – 55 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	10 %	12 – 15 %
D	Lëndë plotësuese	14.4 %	10 – 15 %
E	Detyrime përmbyllëse	3.3 %	3 – 5 %

Kategoria “C”, lëndë ndërdisiplinore/ integruese, është parashikuar me 18 kredite ECTS (10%), e cila është më pak se minimumi i parashikuar në VKM 41/2018 e ndryshuar, e cila kërkon së paku 21.6 kredite ECTS (12%).

Megjithatë, kjo mospërputhje, është formale, pasi lëndët e parashikuara në kategorinë “C” janë:

- Hyrje në Informatikë
- Strukturë të dhënash në C++
- Algoritmikë dhe programim JAVA
- Sisteme Shfrytëzimi

Ndërsa në kategorinë “B” ka lëndë që logjikisht mund të jenë pjesë edhe në kategorinë “B” ose/ edhe në atë “C”, sikurse është lënda “Informatikë 3”. Pra, edhe pse formalisht, numri i krediteve të parashikuara në kategorinë “C” nuk është i plotë, njohuritë e kësaj kategorie, janë të parashikuara të plota në planin mësimor.


Nga shqyrtimi i VKM 41 të modifikuar me VKM 185, datë 25.03.2021, ndarjet e lëndëve në kategori, për këtë lloj profili studimi, nuk janë të përshtatshme. Kjo pasi në VKM-të e sipër cituara, futen në kategorinë “D”, lëndë të formimit informatik, duke i quajtur ato plotësuese apo si ndërdisiplinore duke i futur në kategorinë “C”, lëndë që për këtë program studimi realisht përbëjnë thelbin karakterizues.

Sikurse e kemi shprehur edhe në draft RVJ, devijimi nga ndarja në përqindje të lëndëve mes kategorive, në rastin konkret është formale për vet natyrën e lëndëve që specifikisht për këtë program studimi, mund të jenë njëkohësisht në dy kategori.

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (*Evidenca 1.6*).

Megjithatë, në organizimin e planit mësimor, vërehet mungesa e një aktiviteti formues praktik. Praktika gjykohet nga GVJ si e nevojshme për një program studimi në fushën e teknologjisë së informacionit.

	Gjithashtu, në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve, vihet re mungesa në mënyrë të qartë të aktiviteteve laboratorike sidomos për lëndët karakterizuese dhe ato ndërdisiplinore (<i>Evidenca 2.1</i>).
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” nuk është i detajuar me ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit për çdo aktivitet didaktik si Leksione, Seminare, ushtrime, laboratorë apo detyra kursi. Institucioni gjithashtu nuk ka zbatuar një rregull uniform në ndarjen e orëve në auditor për çdo kredit ECTS për tipologjitë e aktiviteteve formuese si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj.</p> <p>Nëse i referohemi planit mësimor të paraqitur në <i>Evidencë 1.6</i> në RVB, duke marrë si shembull lëndë të kategorisë B, në planet mësimore disa lëndë paraqiten me një ngarkesë prej 10 orë/1 kredit ECTS në auditor. Për disa lëndë të tjera, po të kësaj kategorie, paraqiten me një ngarkesë totale në auditor prej 11 orë/1 ECTS.</p> <p>Në mënyrë të ngjashme vërehet edhe për lëndë të kategorive të tjera, si ato të kategorisë D, ku një lëndë paraqitet me një ngarkesë në auditor prej 7.5 orë/1 ECTS dhe një tjetër me 11.6 orë/ ECTS.</p> <p>Në planet mësimore nuk paraqitet numri total i krediteve ECTS për lëndën dhe as ndarja e tyre në aktivitete formuese. Pra nuk ka një informacion se sa kredite janë të parashikuara për leksione, sa për seminare, laboratorë apo detyra kursi. Pra, jepen kreditet totale të lëndëve pa i ndarë ato në kredite për leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj.</p> <p><u>GVJ, edhe pse vlerëson të nevojshme saktësimet e më sipërme për ndarjen e krediteve brenda çdo lënde, por gjithashtu vlerëson se njësisia bazë (departamenti) përgjegjës për këtë program studimi, ka zbatuar udhëzimet institucionale në hartimin e plan-programeve të lëndëve. Pra edhe pse sugjerimet qëndrojnë, ato nuk janë kompetencë e njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi apo rregulloreve që hartohen prej saj, por duhen vlerësuar në nivel akreditimi institucionale si pjesë e akteve rregullatore të hartuara në nivel Universitetit.</u></p> <p>Në syllabuset e lëndëve, jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminare, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj (<i>Evidenca 2.1</i>).</p> <p>Frekuentimi/ ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Vlerësimi i dijeve është i përcaktuar për secilën lëndë në syllabusin përkatës dhe mund të jetë me Vlerësim të Vazhduar apo me provim përfundimtar. Në tërësi, vlerësimi i dijeve bazohet në zërat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrje dhe aktivizim - Detyrë kursi - Laborator - Kontrolle të ndërmjetme - Provimi përfundimtar <p>Planet programet e lëndëve (syllabuse), përmbajnë në tërësi informacionet e kërkuara nga VKM 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar</p>




	<p>për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p><i>Megjithatë, në syllabuse nuk paraqiten kreditet ECTS të parashikuara për lëndën. Nuk paraqiten gjithashtu, as ndarja e tyre në aktivitete didaktike.</i></p> <p><u>Sugjerim që është i vlefshëm në nivel institucioni dhe jo vetëm për këtë program studimi, i cili ndjek dhe zbatohet aktet e brendshme rregullatore, të cilat nuk janë kompetencë e tij për tu modifikuar.</u></p> <p>Në hartimin e disa prej syllabuseve të lëndëve, vërehet që ka pasaktësi në numrin total të orëve në auditor + atyre për studim individual, numër që nuk përputhet me ngarkesën që duhet të ketë lënda, referuar krediteve ECTS të paraqitura në planin mësimor (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>).</p> <p><u>Për sa më sipër, institucioni, mbasi analizoi draft-raportin, paraqiti si dokumentacion shtes, syllabuset e lëndëve për vitin akademik 2022-2023.</u></p> <p><u>Nga analiza e syllabuseve të paraqitura si dokumentacion shtesë, vërejmë se institucioni i ka plotësuar ato me saktësi sipas formatit dhe informacionit të parashikuara në aktet rregullatore të Universitetit të Tiranës, duke qenë edhe formati i unifikuar në rang universiteti.</u></p> <p><u>Edhe pse në GVJ, gjykojmë se formati i syllabusit duhet të pasurohet me informacione të tjera sikurse është ndarja e krediteve për çdo aktivitet didaktik të parashikuar për lëndën (leksione, seminare, laborator, detyra/projekte kursi etj.), ato nuk janë pjesë e kompetencës së njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, dhe gjykojmë se duhet të jenë pjesë e vlerësimit institucional dhe jo të programit të studimit.</u></p> <p>Sugjerojmë që institucioni të mbajë një ndarje uniforme të ngarkesës për kredit për secilin aktivitet formues, dhe nëse gjykon se studenti duhet të ketë një ngarkesë më të madhe apo më të ulët në auditor, të ndryshojnë ndarjen e krediteve brenda aktiviteteve të ndryshme formuese.</p> <p><u>Sugjerim që është i vlefshëm në nivel institucioni dhe jo vetëm për këtë program studimi, i cili ndjek dhe zbatohet aktet e brendshme rregullatore, të cilat nuk janë kompetencë e tij për tu modifikuar.</u></p> <p>Në këtë mënyrë bëhet e mundur vlerësimi cilësor dhe sasior i ngarkesës si për stafin akademik, por edhe për studentët për përfitimin e njohurive përkatëse.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (<i>Evidenca 2.21, Evidenca 1.19, Evidenca 5.8</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për</p>	<p>Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/ lektorët që do të zhvillojnë modul/ lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/ lëndës njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti;</p>

<p>programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>objektivat e modulit/ lëndës; aftësitë dhe kompetencat që fitohen me përvetësimin e njohurive të lëndës, elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën (<i>Evidenca 1.6</i>).</p> <p>Megjithatë, sikurse është përmendur edhe në kritere të tjerat më sipër, në syllabuset e lëndëve, <i>mungon përcaktimi i krediteve ECTS për lëndën</i>, dhe gjithashtu edhe ndarja e tyre në aktivitete didaktike përkatëse. Ky informacion është në mangësi me atë të kërkuar nga VKM 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>). Gjithashtu, në këto syllabuse, paraqiten si “Përgjegjës i Lëndës”, terminologji që nuk përkon me atë të përcaktuar po në VKM 41, e cila kërkon përcaktimin e titullarit të lëndës.</p> <p>Ajo që vërehet nga syllabuset e paraqitura, “Përgjegjësi i Lëndës” është ai që edhe e ka firmosur atë, çka e paraqet atë si titullar të saj. Në disa prej syllabuseve të paraqitura, përgjegjësi i lëndës, ka kualifikimin “Master i Shkencave”, <i>kualifikim i cili nuk është në përputhje me nenin 49 të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe përkufizimin e Titullarit të lëndëve (Evidenca 2.1)</i>.</p> <p>Në planin mësimor, paraqitet lënda “Informatikë 3” por në këtë program studim, nuk ka lëndë të emërtuara si “Informatikë 1”, dhe “Informatikë 2”. Institucioni të jetë i kujdesshëm në emërtime e lëndëve, dhe në veçanti nëse ato janë të numëruara, pasi kjo nënkupton që do të ketë të paktën edhe një vijueshmëri të lëndës. Në këtë rast sugjerojmë të hiqet numri mbas emrit të lëndës.</p> <p><i>Ne si GVJ i sugjerojmë institucionin të përditësojë programet e lëndëve (syllabuset) në përputhje me kërkesat e VKM 41, datë 24.1.2018.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstaton se stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik. Sipas RVB, programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme (<i>Evidenca 1.21, Evidenca 2.17, Evidenca 1.3, Evidenca 1.30</i>).</p> <p>Edhe pse argumentet e trajtuara në syllabuse për secilën lëndë janë në përputhje me objektivat specifike të njohurive të trajtuara, në hartimin e syllabusive u vunë re disa pasaktësi teknike sikurse është përmendur më sipër në këtë raport.</p> <p>GVJ hasi vështirësi në shqyrtimin e përputhshmërisë së literaturës me kriteret dhe standardet e cilësisë pasi në disa prej tyre mungonte viti i botimit apo identifikimi unik ISBN. Kjo kërkoi një angazhim me të madh të GVJ për të kuptuar nga të dhënat e ofruara në syllabuse, literaturën e saktë, përmbajtjen dhe vitin e botimit (<i>Evidenca 1.6</i>).</p> <p>Sugjerojmë që institucioni të hartojë syllabuset e lëndëve dhe në veçanti të literaturës, konform standardeve bibliografike të citimit dhe referencave, ku së paku, duhet të përmbahen të dhënat e nevojshme dhe të mjaftueshme për identifikimin unik të literaturës së përdorur në formë: <i>...emri dhe mbiemri i autorit/autorëve, titulli i librit, shtëpia botuese, vendi dhe viti i botimit ... si për shembull:</i></p>

	<p><i>Aldous, J.M. and Best, S. and Wilson, R.J., Graphs and Applications: An Introductory Approach, Springer London, 2003, ISBN: 9781852332594</i></p> <p><u>Për sa më sipër, institucioni, mbasi analizoi draft-raportin, paraqiti si dokumentacion shtes, syllabuset e lëndëve për vitin akademik 2022-2023.</u></p> <p><u>Nga analiza e syllabuseve të paraqitura si dokumentacion shtesë, vërejmë se institucioni i ka plotësuar ato me saktësi sipas formatit dhe informacionit të parashikuara në aktet rregullatore të Universitetit të Tiranës, duke qenë edhe formati i unifikuar në rang universiteti.</u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmblotshëm	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4				
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është i organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total (<i>Evidenca 1.6</i>). Konstatohet se ky organizim është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndarja e orëve mësimore, për vitin akademik 2021-2022 është si më poshtë (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>):</p>			
		<p>Mësim në auditor dhe punë e pavarur</p>		<p>Total orë / (180 ECTS)</p>
	Viti akademik	Auditor	Studim individual	
	Viti I	600	900	1500
	Viti II	600	900	1500
Viti III	620	880	1500	
Total	1820	2680	4500	
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve (<i>Evidenca 2.2</i>). Lëndët që përdorin punën laboratorike ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës.</p> <p><i>Mungesa e praktikave profesionale (Evidenca 1.6) që të mund të realizohen pranë institucioneve publike apo private shihet nga GVJ si një mangësi për të rritur punësimin e studentëve dhe në përvetësimin e njohurive sipas nevojave të tregut të punës.</i></p> <p>Megjithatë, personeli akademik është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive praktike studentëve dhe kjo vërehet edhe në takimin me studentët, ku prej tyre u konfirmua impenjimi i stafit akademik në orë praktike si në laborator ashtu edhe në punime individuale të studentëve.</p>			

	<p>Institucioni ka në funksion një sërë marrëveshjes institucionale, por kapacitetet e tyre nuk janë shfrytëzuar plotësisht në funksion të programit të studimit, aq më tepër që plani mësimor nuk parashiko një lëndë praktike.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional (<i>Evidenca 1.6</i>). Studentët e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Infomatike” janë vlerësuar shumë pozitivisht në disa projekte që kanë marrë pjesë dhe kjo është përdorur si një masë për të vlerësuar kompetencat e fituara në programin e studimit të ofruar.</p> <p>Edhe pse ndarja në kredite ECTS është e tillë që lejon përçimin e njohurive kundrejt objektivave të vet programit të studimit, institucioni nuk ka zbatuar një rregull uniform në ndarjen e orëve në auditor për çdo kredit ECTS për tipologjitë e aktiviteteve formuese si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>).</p> <p><u>GVJ, edhe pse vlerëson se rekomandimi i më sipërm për ndarjen e krediteve brenda çdo lënde qëndron, por gjithashtu vlerëson se njësisia bazë (departamenti) përgjegjës për këtë program studimi, ka zbatuar udhëzimet institucionale në hartimin e plan-programeve të lëndëve. Pra edhe pse sugjerimet qëndrojnë, ato nuk janë kompetencë e njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi apo për rregulloret e hartuara prej saj, por duhen vlerësuar në nivel akreditimi institucionale si pjesë e akteve rregullatore të hartuara në nivel Universitetit.</u></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës (<i>Evidenca 2.1, Evidenca 1.6</i>) janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti i parë: 18 orë teori / 23 orë praktikë - Viti i dytë: 18 orë teori / 22 orë praktikë - Viti i tretë: 18 orë teori / 22 orë praktikë <p>Raporti i caktuar më sipër, rreth 50% me 50% është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe të përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Megjithatë, sikurse është përmendur edhe në kriteret e më sipërme, kundrejt programeve të ngjashme të ofruara nga IAL kombëtare publike apo private, në këtë program studimi mungon një lëndë “Praktikë profesionale”.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuar në këtë program studimi (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>).</p> <p>Vlerësimi me kredite ECTS (<i>European Credit Transfer and Accumulation System</i>), i cili në parim ka pikërisht mundësinë e mobiliteteve, transferimit dhe njohjene e dijeve të përvetësuara (<i>Evidenca 2.21</i>), kërkon që institucionin të tregohet më i kujdesshëm në hartimin e dokumentacionit bazë të programit të studimit.</p> <p><i>Hartimi i syllabuseve të lëndëve dhe planit mësimor, të rishikohet në kuadër të VKM 41 dhe të përfshijë të gjitha informacionet e nevojshme për njohjen dhe transferimin e krediteve.</i></p>

<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/ moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programi i studimit, objekt i këtij vlerësimi të jashtëm, është në nivel Bachelor, dhe 20% të planit mësimor përbëhet nga lëndë të kategorisë A (Lëndë Bazë) të cilat përfshijnë lëndë të grupimeve matematikë, fizikë e të tjera të ngjashme (<i>Evidenca 2.1</i>). Për një pjesë prej tyre, ndryshimet në plane- programet janë shumë të vogla në vite për vetë natyrën e tyre si njohuri bazë. <i>Për këto lëndë vërehet se literatura e detyruar jo gjithnjë është e pesë viteve të fundit.</i> Megjithatë, edhe gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me stafin akademik, vihet re se edhe në këto lëndë, pedagogët përgjegjës azhurnojnë literaturën plotësuese me pjesë apo publikime të reja për të mundësuar përvetësimin e njohurive të reja (<i>Evidenca 1.21</i>). Për natyrën e këtyre lëndëve, azhurnimi i literaturës është më i ngadaltë se për lëndë të kategorisë B apo D. Megjithatë, vërehet nga stafi akademik një vështirësi në gjetjen e literaturës së përditësuar në gjuhën shqipe, jo vetëm për këtë grup lëndësh, por në përgjithësi për lëndë të profilit të studimit në informatikë apo në teknologjinë e informacionit në tërësi. Megjithatë, duke parë edhe ritmet e shpejta të zhvillimit të fushën e informatikës dhe teknologjisë së informacionit, njohjen e brezave të rinj të studentëve të gjuhëve të huaja dhe në veçanti të asaj angleze, <i>sugjerojmë përditësimin e syllabuseve me literaturë të 5 viteve të fundit, jo detyrimisht në gjuhën shqipe.</i></p>		
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” garanton përfitimn e njohurive, aftësive themelore (aftësive teknike dhe aftësive të tjera), si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë (<i>Evidenca 2.1</i>).</p>		
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe/ ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës (<i>Evidenca 2.2</i>). Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësimin të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në kompani shumë prestigjioze si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj (<i>Evidenca 1.26a, Evidenca 1.26b, Evidenca 1.26c</i>). Edhe nga studimi që ka bërë institucioni, rezulton një pritshmëri e lartë e punësimin të studentëve të këtij programi studimi.</p>		
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimi Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” për të siguruar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit si dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës, konsultohet vazhdimisht dhe merr parasysh propozimet e partnerëve nga tregu i punës (<i>Evidenca 6.10</i>). Komunikimi është përqendruar në diskutime në lidhje me zgjidhjet software që zakonisht përdoren në industri, si dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për punën në grup. (<i>Evidenca 1.29</i>).</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

GVJ konstatoj se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike plotëson kërkesat ligjore në fuqi (*Evidenca 1.16a, Evidenca 1.16b*).

Referuar *tabelave 6 në RVB*, angazhimi i stafit akademik në këtë program studimi është si vijon:

Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim 42 pedagogë nga të cilët 28 PAE dhe 14 PAK (67% / 33%), të cilët kanë mbuluar në total 2516 orë mësimore në një raport PAE/ PAK: 2188/ 328 (87%/ 13%)

Kualifikimi	PAE	PAK:
Prof. Dr.	1	2
Prof. Asoc.	9	2
Dr./PhD	13	4
Msc.	5	6
Gjithsej	28	14

Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim 37 pedagogë nga të cilët 28 PAE dhe 9 PAK (76% / 24%), të cilët kanë mbuluar në total 2516 orë mësimore në një raport PAE/ PAK: 2188/328 (87%/ 13%)

Kualifikimi	PAE	PAK:
Prof. Dr.	1	2
Prof. Asoc.	8	-
Dr./PhD	13	2
Msc.	6	5
Gjithsej	28	9

Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim 39 pedagogë nga të cilët 29 PAE dhe 10 PAK (74% / 26%), të cilët kanë mbuluar në total 2535 orë mësimore në një raport PAE/ PAK: 2208/327 (87.1%/ 12.9%).

Kualifikimi	PAE	PAK:
Prof. Dr.	1	2
Prof. Asoc.	6	-
Dr./PhD	14	3

Msc.	8	5
Gjithsej	29	10

Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim 43 pedagogë nga të cilët 28 PAE dhe 15 PAK (65% / 35%), të cilët kanë mbuluar në total 2561 orë mësimore në një raporti PAE/ PAK: 1752/809 (68.4 %/ 31.6 %).

Kualifikimi	PAE	PAK:
Prof. Dr.	1	3
Prof. Asoc.	6	-
Dr./PhD	14	2
Msc.	7	10
Gjithsej	28	15

Nga tabelat më sipër, vërehet se numri i stafit PAE i angazhuar në këtë program studimi nuk ka ndryshuar në vite duke u mbajtur në 28-29 persona. Ajo që vihet re është ndryshimi i numrit të stafit PAK nga një minimum prej 9 persona në 15. Megjithatë, ngarkesa në orë mësimore, që personeli akademik efektiv ka mbajtur në këtë program studimi është mbi 70% të totalit të orëve në secilin prej viteve akademike të analizuar.

Gjithashtu, në vitin akademik 2018-2019, ngarkesa mësimore e mbuluar nga stafi PAE, ka qenë (68.4%) më e vogël se 70%.

Për analizën e më sipërme, institucioni ka paraqitur komentimin numër 4 për të shpjeguar dhe arsyetuar që realisht ngarkesa mësimore e mbuluar për çdo student, është brenda kuadrit ligjor me së paku 70% e ngarkesës e mbuluar nga staf PAE.


Duke sqaruar se ngarkesa specifike për çdo student, edhe në këtë vit është në masë më të madhe së 70% me staf PAE. Kjo pasi raporti i mësipërm merr në konsideratë orët totale për të gjitha grupet e leksioneve dhe seminareve.

Nëse i referohemi me një shembull të thjeshtë: një lëndë me një total 60 orë në auditor të ndara me 42 orë leksione në auditor të zhvilluara nga staf PAE, dhe 18 orë seminare të zhvilluara nga staf PAK, nëse është vetëm një grup seminari, raporti është 70% PAE (42/60) dhe 30% PAK (18/60). Në rastin konkret, për këtë program studimi, në atë vit akademik kanë qenë më shumë se një grup seminari, por një grup i vetëm leksioni. Nëse kemi një grup leksioni, por dy grupe seminari për këtë lëndë, si raport i paraqitur në tabelat e RVB, janë 42 orë leksione PAE dhe 18+18 orë seminare PAK duke ndryshuar raportin tashmë 54 % PAE (42/ 78) dhe 46 PAK (36/78). Por secili student, ka ndjekur leksionet me staf PAE dhe seminarin përkatës me staf PAK, pra, edhe në këtë rast, secili student, ka ndjekur aktivitetin didaktik në raportin 70% PAE dhe 30 % PAK. Referuar edhe VKM 41 dhe standardeve të cilësisë, flitet për

	<p><u>mbulimin e orëve për të njëjtët studentë në masën së paku 70% nga PAE.</u></p> <p><u>GVJ, në analizën e të dhënave tabelare, të paraqitura për vlerësimin e jashtëm, nuk e kishte të plotë këtë informacion për të gjykuar mbi fenomenin global të mbulimit të ngarkesës për një vit akademik në raportin 68.4%/31.6%. Megjithatë, arsyetimi i paraqitur nga institucioni konfirmohet edhe me numrin e grupeve mësimore të paraqitura në tabelat në RVB, si dhe me qëndrueshmërinë e stafit PAE të përfshirë në këtë program studimi.</u></p> <p><u>Për sa më sipër, komenti i paraqitur nga institucioni qëndron, dhe vlerësimi i paraqitur në draft raport ndryshon duke mos qenë kjo mospërputhje në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.</u></p> <p>Megjithatë, ajo që vihet re, është se njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, nga viti akademik 2018-2019, njësia bazë ka rritur mbulimin e aktivitetit mësimor nga 68.4% në masën 87% në vitet pasardhëse, duke mbajtur kështu edhe raportin e kërkuar në aktet rregullatore.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Duke analizuar dosjet personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të angazhuar në programin të studimit (<i>Evidenca 2.4, Evidenca 2.5</i>), rezulton se të gjithë kanë kualifikimin e duhur akademik në nivelin e kërkuar, për të menaxhuar modulet e lëndëve të programeve të studimit, ato kanë eksperiencë dhe veprimtari shkencore të gjerë (<i>Evidenca 2.6, Evidenca 1.14</i>).</p> <p>Megjithatë sugjerohet që institucioni të motivojë më tej kualifikimin e personelit akademik, në veçanti atë me formimin Master i Shkencave (Msc).</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në CV e stafit akademik (<i>Evidenca 1.14</i>), niveli i kualifikimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike akademike dhe kërkimore e personelit akademik që mbulon programin e studimit është në përputhje me programin e studimit, me natyrën dhe specifikimet e moduleve të tij. Lektorët punojnë në fushat e kërkimit që përputhen me konceptet e mësuara në programin e studimit bachelor dhe ato përfshijnë elemente të fushës të tyre të kërkimit në lëndë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti i Matematikës së Aplikuar, angazhon personelin akademik dhe atë ndihmës për përmbushjen e objektivave të programit. Për këtë, departamenti ushtron një rol të veçantë për ekuilibrimin e ngarkesës së personelit në funksion të elementëve të ndryshëm përbërës të programit të studimit si dhe angazhim të personelit akademik me formim specifik nga njësi të tjera bazë brenda asaj kryesore (<i>Evidenca 1.14, Evidenca 2.4, Evidenca 2.5</i>).</p>

instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Edhe pse programi i studimit nuk parashikon një lëndë “Praktikë Profesionale”, stafi akademik dhe studentët kanë kontakte të vazhduara me përfaqësues të biznesit të cilët janë punëdhënës potencial për studentët e diplomuar në këtë program (<i>Evidenca 1.20, Evidenca 1.29</i>). Partnerët e biznesit krijojnë mundësi bashkëpunimi si në ide dhe opinione në zhvillimin e programit të studimit sipas nevojave të tregut të punës por edhe në formimin e përgjithshëm të studentëve.			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se zhvillimi i seanceve laboratorike mbështetet prej asistenteve (laborant). Kontributi i tyre dhe i personelit administrativ shkon edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve (<i>Evidenca 2.26</i>). Megjithatë, numri i orëve laboratorike të parashikuara në këtë program studimi është i ulët (<i>Evidenca 1.6</i>). Departamenti i Matematikës së Aplikuar, angazhon personelin akademik dhe atë ndihmës për përbushjen e objektivave të programit dhe këtë e konfirmuan edhe studentët gjatë takimit të zhvilluar (<i>Evidenca 2.25, Evidenca 6.22</i>).			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, institucioni ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të ndryshme dhe bashkëkohore të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve (<i>Evidenca 3.2, Evidenca 3.4</i>). Institucioni tregon vullnet në sigurimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe mjedisit të nxënies. Sidomos gjatë periudhës së pandemisë së krijuar nga virusi Sars-Cov-2 (covid-19), institucioni ka hartuar udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie ku ndër to veçojmë përdorimin e platformës Microsoft Teams (<i>Evidenca 4.24</i>) dhe asaj Google.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e mësimdhënies në mënyrë periodike dhe për këtë trajnon edhe stafin me aktivitete të vazhduara (<i>Evidenca 5.3</i>). Bazuar në rregulloren e njësisë bazë, drejtuesi i njësisë bazë, ka detyrim vlerësimin periodik të mësimdhënies për stafin akademik. Gjithashtu, monitorimi i cilësisë nuk bazohet vetëm në vlerësimet e zhvilluara nga drejtuesi i njësisë bazë (<i>Evidenca 3.40</i>), por bazohen edhe në pyetësorët periodikë të realizuar me studentët.</p> <p>Njësia kryesore, gjithashtu, monitoron në mënyrë të vazhduar edhe zhvillimin e aktiviteteve didaktike në auditor (<i>Evidenca 3.40</i>).</p> <p>Bazuar në rregulloren e njësisë bazë dhe të asaj institucionale, studentët në fund të secilës lëndë apo modul plotësojnë një pyetësor në formë anonime rreth të gjithë aspekteve të mësimdhënies ku ndër të tjera mblidhen mendimet e studentëve rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Materialeve mësimore, mjaftueshmërinë dhe cilësinë e tyre për të ndjekur dhe kuptuar lëndën, - Aftësitë gjithëpërfshirëse të pedagogut në aktivitetin mësimor - Përdorimi i metodave multimediale apo ndihmëse inovative në funksion të mësimdhënies, - Aftësitë komunikuese në funksion të përcimit të dijeve tek studentët - Zhvillimin e të gjithë orëve mësimore/didaktike të parashikuara në planin mësimor - Gjithashtu, hartohen edhe pyetje që lidhen me studentit dhe frekuentimin e tij të aktiviteteve didaktike apo edhe studimin individual. - Pyetësori përfshin edhe shumë aspekte të tjera të lidhura jo vetëm me mësimdhënien por edhe me të gjithë infrastrukturën në tërësi të institucionit në funksion të përcimit të dijeve. <p>Në vijim të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, hartohen nga personeli akademik edhe raporte të vetë vlerësimit me qëllimin e vënies</p>

	në dukje të problematikave nëse ka dhe/ apo sugjerimeve për përmirësime të mëtejshme.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	<p>Studentët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit periodik jo vetëm të mësimdhënies por në tërësi të të gjithë aspekteve cilësore institucionit, përfshirë këtu ambientet si salla leksionesh, seminaresh, laboratorë, biblioteka etj (<i>Evidenca 3.7a, Evidenca 3.7b</i>).</p> <p>Studenti ka të drejtën të ankimojë pranë njësisë bazë, asaj kryesore apo në institucion nëse ndaj tij janë shkelur të drejtat që i lindin nga statusi student pranë këtij institucioni. Procedurat e ankimit janë të parashikuara si në rregulloren institucionale të Universitetit të Tiranës ashtu edhe në atë të njësisë bazë, ku studenti mund të ankimojë vlerësimin apo procedurat e ndjekura për vlerësimin e dijeve të tij.</p> <p>Bazuar edhe në gjetjet e pyetësorëve dhe takimet me partnerët e biznesit, hartohen edhe masat për rishikimin e programeve të studimit në tërësi (<i>Evidenca 3.8, Evidenca 2.17</i>).</p>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në Universitetin e Tiranës . Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet nga drejtuesi i njësisë bazë (Përgjegjësi i Departamenti) dhe ai i njësisë kryesore (Dekani) (<i>Evidenca 6.22, Evidenca 6.19</i>). Ata vlerësojnë performancën e personelit akademik me anë të formularit të vlerësimit, që plotësohet gjatë vizitës, në një orë mësimi (<i>Evidenca 6.16</i>).</p> <p>NJBSC analizon, mbi bazën e metodave statistikore, vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe harton një raport individual për secilin anëtar të stafit akademik (<i>Evidenca 6.17, Evidenca 6.22</i>). Raporti komunikohet tek autoritetet drejtuese të Universitetit të Tiranës. Ky raport i bëhet i ditur gjithashtu përgjegjësit të njësisë bazë, i cili vë në dijeni të vlerësimit të bërë nga studentët në mënyrë konfidenciale personelin akademik. NJBSC gjithashtu harton një raport të përmbledhur në nivel institucional (<i>Evidenca 4.32, Evidenca 6.18, Evidenca 6.19, Evidenca 6.2, Evidenca 6.20, Evidenca 6.21</i>).</p> <p>(https://fshn.edu.al/Info/dega-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-dhe-karrieres).</p>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	<p>GVJ, në bazë të dokumenteve konstaton se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies ne auditor te personelit akademik, nëpërmjet trajnimeve te vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira (<i>Evidenca 3.21, Evidenca 3.1</i>). Gjithashtu, në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, mbahen në mënyrë periodike edhe leksione të hapura (<i>Evidenca 3.10, Evidenca 3.11, Evidenca 3.12, Evidenca 3.13, Evidenca 3.14</i>), me qëllim promovimin e praktikave më të mira në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit (<i>Evidenca 2.1</i>). Syllabuset e lëndëve miratohen në departament. Gjithashtu, plani mësimor është në përputhje me Rregulloren e Miratuar të programit (<i>Evidenca 1.6</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike" merr pjesë në trajnimet e orientuara në aspektet didaktike të mësimdhënies të organizuara nga Universiteti i Tiranës (<i>Evidenca 3.14, Evidenca 4.12</i>). Gjithashtu gjatë punës me studentët ata nxiten të përdorin metoda inovative të mësimdhënies. Personeli akademik merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënies sa më të mirë. Disa nga metodat e përdoruar gjatë mësimdhënies janë: simulimi, video, përdorimi software-ve të caktuar për të kryer analiza të pavarura etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni demonstroi se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe ka mbështetur personelin e tij akademik me ngritjen e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Univesitetin e Tiranës, e cila mundëson trajnimin dhe aplikimin e metodave të ndryshme pedagogjike të mësimdhënies (<i>Evidencë 3.13</i>). Për këtë qëllim mbështet organizimin e aktiviteteve shkencore si konferenca të organizuara nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera. Gjithashtu stafi akademik këshillohet të marrë pjesë në aktivitete të tjera shkencore, por në këto raste, mbështetja ekonomike e institucionit është thujtë e pa përfillshme ose mungon krejtësisht. Në shumicën e rasteve për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë vendit, stafi akademik i mbulon vetë shpenzimet, ose në rastin më të mirë, mbështetet nga institucionet partnere. Kjo sjell një barrë të lartë</p>

	<p>ekonomike dhe një pengesë shumë të madhe për stafin akademik për të përparuar në karrierën akademike dhe atë shkencore.</p> <p>Brenda institucionit, stafi akademik më me përvojë përpiqet për të motivuar dhe trajnuar stafin më të ri, apo atë që nuk është i fushës së teknologjisë së informacionit (<i>Evidenca 3.10, Evidenca 3.11, Evidenca 3.12</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Programi i studimit mbulohet në masën më të madhe nga personel akademik i institucionit në tërësi. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në lëndët që mbulojnë dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie (<i>Evidenca 1.14, Evidenca 1.16b, Evidenca 2.6, Evidenca 2.25</i>). Edhe pse një pjesë e stafit akademik me kualifikimin “Master i Shkencave” dhe aktualisht në proces doktorature, kanë një përvojë të gjatë mbi 10-vjeçare në këtë institucion si lektor/ asistent lektor.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe përditëson periodikisht mënyrat dhe metodat e mësimdhënies me anë të implementimit të Pyetësorëve mbi Vlerësimin e Lektorit të Lëndës i cili është një nga mjetet kryesore të përdorura për kontrollin e cilësisë të mësimdhënies. Ky pyetësor mbahet në bazë semestrale. Raporti i vihet në dispozicion çdo pedagogu dhe strukturave drejtuese (<i>Evidenca 1.26a, Evidenca 1.26b, Evidenca 1.26c</i>).</p> <p>Nga takimi me studentet u konstatua se ky mekanizëm kishte funksionuar në disa raste në përmirësimin e mësimdhënies në disa lëndë formuese bazë ku mangësitë e studentëve në njohuritë paraprake nga shkolla e mesme, ishin plotësuar me ndihmën e stafit akademik të institucionit (<i>Evidenca 3.8</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Në përgjithësi, personeli akademik në punën e përditshme gjatë procesit mësimor, synon të kalojë nga metoda tradicionale e të mësuarit në metodën e interaktivitetit në procesin mësimor duke synuar rritjen e rolit të punëve praktike, projekteve, integritit në punën shkencore të pedagogëve, punës në grup etj. Përmes këtyre transformimeve synon të nxiten dhe zhvillohen cilësi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) kreativiteti; b) puna në grup dhe komunikimi i ndërsjellë; c) ndërgjegjësimi dhe marrja e përgjegjësisë; ç) individualiteti; d) zhvillimin i imagjinatës krijuese dh) zhvillimi i iniciativës për të vepruar; e) Të shprehurit korrekt me shkrim dhe me gojë. <p>Në përgjithësi, gjatë periudhës së zhvillimit të aktivitetit didaktik online, stafi akademik ka rritur rëndësinë e zhvillimit të projekteve të lëndëve nga ana e studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga</p>	<p>Në diskutim edhe me pedagogët, GVJ konstaton se mësimdhënia në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit dhe zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të</p>

mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenarë realë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” ka në dispozicion katër godina dhe janë të emërtuara A, B, C dhe D (<i>evidencë 4.8</i>). Këto godina kanë hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. Sallat e leksioneve, seminarëve dhe ambienteve laboratorike janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht nga personeli sanitar i Degës të Shërbimeve (<i>evidencë 1.17</i>).</p> <p>Godina A ka 4 kate dhe ka në përbërje të saj: 10 Salla nga të cilat 2 salla leksionesh dhe 8 salla seminarësh. Kapaciteti total i Godinës A është 588 vende studenti me sipërfaqe totale 502.62 m² Godina B ka 4 kate dhe ka në përbërje të saj 4 salla leksioni me kapacitet total prej 328 vende studenti dhe me sipërfaqe totale 288.6 m².</p> <p>Godina C ka 3 kate dhe ka në përbërje të saj 8 salla të cilat përdoren kryesisht si salla seminari por në varësi të numrit të studentëve mund të përdoren edhe si salla leksioni. Kapaciteti total i Godinës C është 486 vende studenti me sipërfaqe totale 496.68 m². Godina D ka 6 kate dhe ka në përbërje të saj 6 salla leksionesh me kapacitet total 694 vende studenti dhe me sipërfaqe totale 1107.3 m² (<i>evidencë 4.8</i>).</p> <p>Bazuar në raportet periodike të hartuara nga institucioni, vihet re një numër i lartë i studentëve në një grup seminari. Sipas raportit të hartuar për vitin akademik 2020-2021, (<i>evidenca 1.26c</i>) në pikën 3.4, faqe 78 të tij, Fakultetin e Shkencave të Natyrës raporton se numri i studentëve për grupe seminari ka qenë nga 35 në 45 studentë.</p> <p>Bazuar në VKM 41, datë 24.01.2018, për “Elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, parashikohet maksimumi 35 studentë/ seminar për fushën e studimit “Shkenca Natyrore” dhe maksimumi 25 studentë/ seminar për fushën e studimit Inxhinieri dhe Teknologji.</p> <p>Nga sa më sipër, ngritja e grupeve mësimore për seminare me deri në 45 student, si në njësinë kryesore “Fakulteti i Shkencave të Natyrës”, ashtu edhe në atë specifike të këtij programi studimi me karakter Inxhinierik (Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike), është një numër më i lartë se ai i parashikuar për standardet e cilësisë në fuqi.</p> <p>Megjithatë, FSHN, ka parashikuar që numri i studentëve për aktivitetet Laboratorike të mos jetë më i madh se 15, çka është më mirë se</p>

	<p>maksimumi i parashikuar po në VKM 41, i cili parashikon deri në 20 student/ laborator për fushën e Inxhinierisë dhe Teknologjisë apo 25 student/ laborator për fushën e shkencave natyrore (<i>Evidencë 1.26a, Evidencë 1.26b, Evidencë 1.26c</i>).</p> <p><i>Sugjerohet institucionin të zvogëlojë numrin e studentëve për grupe seminari në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënjes</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, ka në dispozicion vetëm një laborator të teknologjisë së informacionit (<i>Evidenca 4.9</i>). Laborator i cili shfrytëzohet kryesisht për aktivitetet didaktike të parashikuara në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike dhe Informatike. Në mbulimin e aktiviteteve didaktike të parashikuara në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike, shfrytëzohen edhe laboratorët e Departamentit të Informatikës (<i>Evidenca 1.26a, Evidenca 1.26b, Evidenca 1.26c</i>).</p> <p>Megjithatë, duke konsideruar totalin e lëndëve me bazë informatike që zhvillohen në FSHN, numri total i laboratorëve në dispozicion dhe oraret përkatëse të shfrytëzimit, nuk janë të mjaftueshme për një program të tillë studimi.</p> <p><i>Ne si GVJ, sugjerohet institucionit, të rrisë kapacitetet laboratorrike në funksion të këtij programi studimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët e Universitetit të Tiranës përdorin sisteme IT të zhvilluara apo të përshtatura si (<i>Evidenca 3.18, Evidenca 4.8.3, Evidenca 4.25</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Moodle LMS & Microsoft Teams sisteme që mund të përdoret për të publikuar materialin mësimor, në lidhje me lëndët përkatëse, për të komunikuar pedagogët me studentët etj. - “Ngarkesa mësimore” i cili u vjen në ndihmë përgjegjësve të njësive bazë dhe dekanëve për ndarjen e ngarkesës mësimore e raportimin e saj. - “Sistemi i Menaxhimit Online të Bibliotekës të Universitetit të Tiranës ” i cili mundëson studentët dhe personelin akademik të kërkojnë dhe të rezervojnë libra për huamarrje. - “Sistemi i Vlerësimit online i pedagogëve dhe nxënësve” i cili i vjen në ndihmë NJBSC për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve nga studentët - “Sistemi i kontratave”, i cili thjeshton procesin e regjistrimit të studenteve të rinj në Universitetin e Tiranës dhe harton automatikisht kontratën e studentit. - Pajisja e studentëve, staffi akademik dhe ndihmës akademik me adresë të postës elektronike zyrtare në domain të institucionit në formën: <ul style="list-style-type: none"> o emer.mbiemer@fshn.edu.al o emer.mbiemer@unitir.edu.al o emer.mbiemer@fshnstudent.info o emer_mbiemer.fshnstudent@unitir.edu.al

<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në plan programet e lëndëve të këtij programi studimi (<i>Evidenca 1.6</i>), literatura e parashikuar si e detyrueshme gjendet në bibliotekën e institucionit. Literatura e përgatitur nga pedagogët e lëndëve në formë konspektesh u jepej studentëve nga vet pedagogët dhe një kopje ruhet në njësinë bazë. Edhe pse literatura e përdorur për këtë program studimi gjendet në institucion, ajo nuk është e azhornuar me botime të pesë viteve të fundit (<i>Evidenca 2.1</i>).</p> <p>Për lëndët e formimit bazë në kategorinë e lëndëve si matematika, fizika apo kimi, që përbëjnë thellimin e njohurive bazë për studentët e këtij programi studimi, argumentet e trajtuar janë në përputhje me ato që gjenden në literaturën e rekomanduar, edhe pse nuk është e pesë viteve të fundit. Megjithatë, për lëndë karakterizuese, <i>sugjerojmë institucionin të përditësojë literaturën e përdorur me edicionet e reja që trajtojnë edhe ndryshimet teknologjike më të fundit në këtë sektor.</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Literatura e nevojshme për zhvillimin normal të aktivitetit mësimor është e disponueshme në formën libri në bibliotekën e Fakulteti të Shkencave Natyrore. Në fillim të çdo semestri të gjithë lektorëve me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesshme, ju kërkohet të përcaktojnë literaturën që planifikojnë të përdorin në aktivitetin didaktik (<i>Evidenca 4.8.3</i>). Kërkesat e tyre paraqiten në Departament dhe shërbejnë si kërkesa për pasurimin e fondit të bibliotekës. Studentët gjithashtu kanë qasje edhe në formën software të materialeve të siguruara nga personeli akademik në platformën online të institucionit dhe ato të ofruara nga vet pedagogët në formë dispense apo shënime të lëndës.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ka një fond të gjerë librash, jo vetëm për zhvillimin normal të procesit didaktik, por edhe për kërkimin shkencor.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje qasjeje në bibliotekën digjitale “U-library” të ofruar në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin e cila garanton qasje në databazën EBSCO. Institucioni garanton qasje edhe në librarinë digjitale JSTOR (www.jstor.org) e cila përfshin literaturë në funksion të njohurive të përcuara në këtë program studimi. Studentët mund të përdorin libraritë digjitale edhe nga ambientet e bibliotekës e cila është e pajisur me kompjutera të lidhur në internet. Ofrohet akses në libraritë on-line si (<i>evidencë 1.18 tabela 17</i>).</p> <p>https://www.elgaronline.com/browse?access=user&level=parent https://iopscience.iop.org/journalList https://msp.org/publications/journals/</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka disa laboratorë në funksion jo vetëm të këtij programi studimi por edhe të programeve të tjera të ofruara në këtë njësi kryesore (<i>Evidenca 1.26a, Evidenca 1.26b, Evidenca 1.26c</i>). Megjithatë, në planet mësimore të këtij programi studimi, numri i krediteve dhe orëve përkatëse për laboratorë është i ulët (<i>Evidenca 1.6</i>). Edhe njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, ka në dispozicion vetëm një laborator të teknologjisë së informacionit (<i>Evidenca 4.9</i>). Laborator që përdoret kryesisht për programet e studimit të nivelit Master që janë nën përgjegjësinë e kësaj njësie.</p>

	<i>Duke parë edhe zhvillimet e vrullshme teknologjike në fushën e këtij programi studimi, sugjerojmë rritjen e bazës laboratorike specifike për këtë profil studimi.</i>			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni, dhe në veçanti pedagogët e angazhuar në këtë program studimi kanë përdorur platforma online për pjesë të ndryshme të aktiviteteve didaktike (<i>Evidenca 3.18</i>). Veprimtari që janë rritur në dy vjeçarin e fundit edhe të motivuar nga situata e krijuar prej pandemisë Sars-Cov-2 (Covid-19). Për këtë qëllim, pedagogët e njësisë bazë, Departamenti i Matematikës së Aplikuar, kanë përdorur platforma online si Google Meet, Google Classroom, Microsoft Teams, etj. Bazuar edhe në anketimet e realizuara nga pedagog të këtij fakulteti, përdorimi i platformave online të mësimdhënies janë mirëpritur nga studentët dhe gjykohej që të mund të përdoren me efikasitet përtej kushteve të diktuar nga situata e pandemisë globale (<i>Evidenca 1.26a, Evidenca 1.26b, Evidenca 1.26c</i>).			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Institucioni ka në përdorim sistemin informatik të menaxhimit të informacionit (<i>Evidenca 4.25</i>). Studentët, pedagogët, sekretaria mësimore kanë qasje të kushtëzuar në vartësi të rolit që kanë në institucion (student, pedagog, personel administrativ etj.). Studenti ka qasje vetëm në të dhënat personale apo ato që lidhen me të (nota, të dhëna financiare etj.), Pedagogu ka qasje vetëm në listën e studentëve dhe notat e vendosura në lëndën për të cilën është angazhuar në mësimdhënie, sekretaria mësimore ka qasje në të dhënat e studentit në funksion të aktivitetit normal të saj. Të gjitha këto të dhëna përpunohen nga institucioni në përputhje me rregulloren për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale. Studentet dhe stafi akademik kanë adresë të postës elektronike zyrtare, në domain të institucionit dhe për studentët ekziston portali e-student (<i>Evidenca 3.18</i>). Institucioni është duke integruar sistemin informatik me sistemin qeveritar elektronik E-Albania. Në këtë mënyrë, studentët por edhe ish-studentët, të diplomuar, të kenë qasje elektronike në të dhënat e tyre universitare.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Përmbyllja e studimeve realizohet me provim formimi (<i>Evidenca 3.31, Evidenca 3.32</i>). Stafi akademik në programin e studimit Bachelor në "Inxhinier Matematike dhe Informatike" mbështet studentët në përgatitjen e tyre për përfundimin me sukses të ciklit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës në statutin e tij ka përcaktuar Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore. NJBSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, në kuadër të Universitetit të Tiranës”, në dy aspekte kryesore (<i>Evidenca 6.23, Evidenca 6.24</i>):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit 2. Vlerësimin e Brendshëm Institucional. <p>NJBSC bashkëpunon me Dekanët e Fakulteteve për çdo vlerësim të brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të NJBSC shërbejnë si bazë për zyrën e kërkimit shkencor për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik (<i>Evidenca 6.3, Evidenca 6.4</i>).</p> <p>Megjithatë, duke analizuar numrin e programeve të studimit, numrin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, <i>sugjerojmë që numri i personelit për Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës të rritet.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Matematikës së Aplikuar është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimin për cilësinë e mësimdhënies midis personelit akademik dhe studentëve (<i>Evidenca 4.28, Evidenca 4.29</i>). Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren institucionale. Duke pasur parasysh që kërkesat për cilësi janë gjithmonë në rritje dhe duke marrë parasysh që fusha kërkon azhurnime të vazhdueshme, departamenti ka punësuar rregullisht pedagogë duke përdorur fushat kombëtare të shpalljes së vendeve të lira të punës. Personeli akademik ka marrë pjesë në leksionet e mbajtur nga aplikantët.</p> <p>Departamenti bën analiza periodike, mbi bazën e të cilave shqyrton situatën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së mësimdhënies, duke lënë detyra për zgjidhjen e problematikave të mundshme (<i>Evidenca 6.3, Evidenca 6.4, Evidenca 6.23, Evidenca 6.24</i>).</p> <p>Bazuar në raportimet e vlerësimit të cilësisë dhe udhëzuesit strategjik të metodave inovative hartohen dhe zbatohen module trajnimi.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka një udhëzues strategjik për rritjen e kërkimit shkencor dhe inovacionin (<i>Evidenca 3.1</i>). Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies nga personeli akademik me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe përshtatjen me zhvillimet teknologjike në fushë (<i>Evidenca 3.13, v 3.14</i>). Kjo është treguar më mbështetjen nga IAL të departamentit dhe personelit akademik në pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime të ndryshme dhe bashkëpunimin me universitete të huaja. Megjithatë vihet re se institucioni përveç objektivave për rritjen e mbështetjes së stafit akademik për rritjen e tyre akademike dhe shkencore, ofron një mbështetje të ulët financiare për arritjen e objektivave.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti i Matematikës së Aplikuar, edhe pse ka një përbërje staf akademik në përputhje me kriteret minimale të përcaktuara në ligjin 80/2015 për arsimin e lartë, një pjesë e stafit akademik janë me</p>

<p>vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>kualifikimin “Master i Shkencave” dhe janë në proces të zhvillimit të shkollës doktoale. Stafit akademik, edhe pse me kualifikimin “Msc”, ka një përvojë të gjatë në mësim-dhënie pranë këtij institucioni. Megjithatë vërehet një mbështetje e ulët e institucionit në promovimin e stafit për tu kualifikuar më tej në fushën e tyre të ekspertizës. Disa prej stafit akademik kanë marrë pjesë në shkëmbimet e ofruara nga projektet Erasmus.</p> <p><i>GVJ sugjeron institucionin të mbështes më shumë stafin akademik për të rritur kualifikimet jo vetëm në mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca apo botime në revista por edhe në uljen e ngarkesës akademike për stafin që është në proces doktoate për ta përmbyllur atë. Megjithëse mbështetjen relativisht të ulët institucionale, stafi akademik i njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka marrë pjesë në disa aktivitete shkencore të organizuar në nivel rajonal me mbështetjen dhe koordinimin e këtij stafi (Evidenca 3.9, Evidenca 3.10, Evidenca 3.11, Evidenca 3.12, Evidenca 3.13, Evidenca 3.14).</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në udhëzuesin strategjik për periudhën 2019-2024 për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies (Evidenca 3.1), Universiteti i Tiranës ka planifikuar fushat e zhvillimit profesional të stafit akademik si:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Mësimdhënia me në qendër studentin 2018-2019; – Vlerësimi dhe motivimi i studentëve 2019-2020; – Zhvillimi i të menduarit kritik të studentëve 2020-2021; – Zhvillimi i të menduarit krijues dhe problem-zgjidhja 2021-2022; – Roli i ndërveprimit student pedagog dhe student-student në efektivitetin e të nxënësve 2022-2023; – Puna në grupe, simulimet dhe zbatimimi i teknologjisë në mësimdhënie 2023-2024; <p>Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, ka realizuar herë pas here aktivitete didaktike me pedagog të ftuar në formën e orëve të hapura të cilat shërbejnë si një aktivitet shkëmbim eksperiencash (Evidenca 3.14).</p> <p>Gjithashtu, anëtar të stafit akademik të njësisë bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, kanë realizuar edhe mobilitete për rritjen e tyre akademike (Evidenca 4.11a, Evidenca 4.11b, Evidenca 4.12).</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik i institucionit dhe personeli ndihmës akademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja (Evidenca 3.14).</p> <p>Kjo përfshin caktimin e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje për kurrikulat e plota. (Evidenca 6.3, Evidenca 6.4).</p>

<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacioneve dhe takimit me personelin akademik konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse (<i>Evidenca 6.7, Evidenca 1.26a, Evidenca 1.26b, Evidenca 1.26c</i>). Departamenti i Matematikës së Aplikuar nxit dhe mbështet stafin akademik. Departamenti ka vendosur si një nga objektivat e tij strategjik “Zbatimin e programeve dhe metodave të mësimdhënies bashkëkohore”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit (<i>Evidenca 1.3</i>). Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik (<i>Evidenca 2.1</i>). Njësia bazë, përgjegjës për këtë program studimi ka dy tipologji të vlerësimit të dijeve të studentëve (<i>Evidenca 2.2, Evidenca 3.27, Evidenca 3.28</i>): E para me Vlerësim të Vazhduar (VLV) ku studentët vlerësohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit didaktik, dhe e dyta me Vlerësim me Provim, ku peshën kryesore e ka vlerësimi në provimin përfundimtar të njohurive</p> <p>Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10% niveli i diskutimit në seminare - 20% detyrë kursi - 30% provimi i ndërmjetëm - 40% provimi përfundimtar
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret e institucionit (<i>Evidenca 1.3</i>) deri në njësinë bazë si dhe në rregulloret e tjera të provimeve (<i>Evidenca 2.2</i>) apo të programit të studimit, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin akademik si dhe me studentet, rezulton se procedura e informimit realizohet nga stafi akademik konform rregulloreve në fuqi.</p> <p>Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës apo të syllabusit përkatës (<i>Evidenca 1.20, Evidenca 2.1</i>).</p>

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Referuar rregulloreve të institucionit, GVJ konstaton se testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj.), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar (<i>Evidenca 2.1</i>). Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Është kompetencë e pedagogut përgjegjës të lëndës shpërndarja e peshës specifike për secilin komponent të vlerësimit. Për këtë studentët janë në dijeni paraprakisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Vlerësimi i dijeve të studentëve, konform rregulloreve institucionale, të njësisë kryesore dhe asaj bazë, bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku peshë në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës (<i>Evidenca 2.1</i>). Njësia bazë, përgjegjës për këtë program studimi ka dy tipologji të vlerësimit të dijeve të studentëve: E para me Vlerësim të Vazhduar (VLV) ku studentët vlerësohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit didaktik, dhe e dyta me Vlerësim me Provim, ku peshën kryesore e ka vlerësimi në provimin përfundimtar të njohurive. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton të jetë: <ul style="list-style-type: none"> - 10% niveli i diskutimit në seminare - 20% detyrë kursi - 30% provimi i ndërmjetëm - 40% provimi përfundimtar
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmit, institucioni ka në përdorim disa platforma elektronike (Microsoft Teams, dhe Office 365) të cilat lejojnë ndërtimin e pyetësorëve apo teste në format quiz-i (me alternativa) dhe e kombinuar dhe me pyetje të natyrës teorike, të cilat korrigjohen nga pedagogu i lëndës. Në këto raste, të pyetjeve me alternativa ku është përcaktuar paraprakisht nga pedagogu se cila është alternativa e saktë, me mbylljen e quiz-it nga studenti, automatikisht gjenerohet edhe vlerësimi i tij bazuar mbi përgjigjet e ofruara. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Notat hidhen në mënyrë elektronike në Sistemin Informativ të Universitetit të Tiranës. Nga takimi me studentët testimi online është realizuar në Microsoft Teams, me kamera hapur.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe	Pas shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës ka përcaktuar në rregulloren institucionale se Dekani miraton

<p>aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>komisionet e provimeve dhe të mbrojtjes së diplomave dhe Përgjegjësi i Departamentit miraton modalitete të vlerësimit dhe ngre komisionet e provimeve të cikleve përkatëse të studimeve në lëndët që mbulon departamenti (<i>Evidenca 1.5, Evidenca 2.2</i>).</p> <p>Sipas RVB komisionet e provimeve kanë së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës (<i>Evidenca 3.3</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ konstaton se provimet me shkrim sekretohen nga personeli i Sekretarisë Mësimore. Në dokumentin GVB citon: Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara të cilat vulosen nga sekretaria mësimore. Ato vendosen në zarf dhe hapen para studentëve dhe komisionit në momentin e fillimit të provimit. Studenti paraqitet në provim me një dokument identifikimi.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive behet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e universitetit të Tiranës. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/ testeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/ prezantimeve të detyrave të kursit/ projekteve, duke iu dhënë këshilla/ orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/ miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren të jenë autentike (<i>Evidenca 3.3</i>).</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës së pedagogut dhe Rregullores së Etikës (<i>Evidenca 1.5</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulët kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi informatik, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament (<i>Evidenca 1.5, Evidenca 3.3</i>).</p> <p>Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda dy ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për</p>	<p>Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim (<i>Evidenca 1.5</i>).</p> <p>Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studentit ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të</p>

<p>rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>përcaktuara në rregullore (<i>Evidenca 6.24</i>). Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë (<i>Evidenca 3.3</i>).</p> <p>Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi, u vu re se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo qartësoshin rreth çdo paqartësie të mundshme direkt me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Studentët vunë në duke disponibilitetin e pedagogëve për sqarime dhe këshillime të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Të drejtat e studentit janë të përcaktuara në rregulloret institucionale të cilat kanë të përcaktuara të gjitha hallkat dhe mënyrat se si dhe kur studenti të kryej një ankesë, si shqyrtohet ajo dhe mënyra e informimit. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion nuk u vu re një praktikë konkrete pasi studentët nuk kishin patur ankesa/ kërkesa që të kërkonin përshkallëzime përtej njësisë bazë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.7</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike në fushën teknologjisë së informacionit si dhe përmbillet me punimin e diplomës (<i>Evidenca 1.4, Evidenca 2.1, Evidenca 2.2</i>). Megjithatë, vërehet mungesa e një lënde/moduli “Praktikë Profesionale” e cila do të ndihmonte studentin të vinte në praktikë njohuritë e përfuara në një ambient real në tregun e punës (<i>Evidenca 1.6</i>).</p> <p>Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Stafit akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Kjo kurrikul parapërgatit studentet për thellimin e studimeve në ciklin master. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë në përthithjen e aftësive në fushën e IT, gjuhëve të programimit, softwareve të ndryshëm etj.</p> <p>Studentet përfshihen edhe në veprimtarinë kërkimore të stafit. Ato inkurajohen për të punuar në grup gjatë procesit mësimor. Në seminare organizohen diskutimet e çështjeve të caktuara duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi.</p>

	Nga shqyrtimi i plan-programeve të lëndëve vërehet se nuk janë parashikuar qartë orët laboratorike, të cilat sipas institucionit janë të përfshira në ngarkesën e ushtrimeve që zhvillohen në laboratorë.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit garanton zhvillimin e veçantë në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Për sa më sipër, në planin mësimor të këtij programi studimi, janë të parashikuara zhvillimi i lëndëve karakterizuese në teknologjinë e informacionit dhe janë parashikuar gjithashtu edhe lëndë me karakter të përgjithshëm si lëndë për aftësimin në gjuhë të huaj (Anglisht), lëndë për aftësimin logjik (Kulturë ekonomike dhe gjuhësore, Hyrje në matematikë financiare), aftësi menaxhuese (Njohje me profesionin) etj (<i>Evidenca 1.6, Evidenca 2.1</i>).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Departamenti i Matematikës së Aplikuar analizon kompetencat profesionale të fituara nga studentët (<i>Evidenca 6.16, Evidenca 6.19, Evidenca 6.17, Evidenca 6.18</i>) dhe i paraqet ato në: Analizën vjetore të tij, mbi arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”. Kujdes i veçantë u kushtohet analizës së lëndëve që janë në vijimësi të lëndëve të tjera në semestrat pasardhës dhe mbahet komunikim midis lektorëve të lëndëve që janë të ndërlidhura.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se në javet e fundit, pedagogët e lëndes informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final (<i>Evidenca 2.1</i>).
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” është angazhuar edhe në veprimtari të tjera, si konferenca (seminare) të ndryshme, ku kanë prezantuar edhe teknologji të ndryshme në auditore të zgjeruara ku marrin pjesë jo vetëm studentet e programit të studimit por edhe studente dhe pedagoge nga programe të ndryshme studimi të fakulteteve të tjera (<i>Evidenca 3.10, Evidenca 3.11, Evidenca 3.12</i>).
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Institucioni garanton qasje në laboratorët e fizikës dhe informatikës për studentët e këtij programi studimi. Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e ndarë qartë aktiviteti laboratorik nga ai i ushtrimeve/ seminareve, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i laboratorëve për lëndën e fizikës dhe disa nga lëndët e fushës së informatikës. Edhe nga stafi akademik, u vu në dukje, se zhvillimi i seanceve laboratorike janë të gërshetuara me ato teorike (seminare/ ushtrime) të cilat studenti motivohet ti zbatojë praktikisht në aktivitet laboratorik.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe	Sipas RVB dhe në bazë të vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instruktin studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve

zgjdhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Përgjithësisht temat e detyrave të kursit janë raste studimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe ofrimin e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër. Detyrat e kursit pjesë e programeve mësimore të çdo lëndë krijojnë klimë të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e ideve inovative. Universiteti i Tiranës, dhe në veçanti Departamenti i Matematikës së Aplikuar mbështet idetë inovatore të studentëve, krijon mundësi për zbatime të avancuara dhe mbështet financiarisht projekte kërkimore të suksesshme (<i>Evidenca 5.2</i>).			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Stafi akademik i njësisë bazë, Departamenti i Matematikës së Aplikuar, mbështet studentët për zhvillimin e ideve të tyre në ambientet e institucionit duke vënë në dispozicion të gjithë bazën laboratorike. Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi u vu në dukje mbështetja dhe ndihma e stafit akademik për studentët në zhvillimin e projekteve (<i>Evidenca 5.2</i>). Megjithatë, nuk vihet re një mbështetje financiare e institucionit për rritjen e studimeve të avancuara kërkimore si për stafin ashtu edhe për studentët.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ ka konstatuar se Universiteti i Tiranës ka marrë pjesë në disa projekte Erasmus (<i>Evidenca 2.19, Evidenca 4.11a, Evidenca 4.11b, Evidenca 4.12</i>). Nëpërmjet tyre institucionin mundëson rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira të institucioneve bashkëpunuese perëndimore, njohuri të cilat më pas aplikohen në auditor apo transferohen tek anëtarë të tjerë të personelit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Universiteti i Tiranës ka hartuar një rregullore diplomimi (<i>Evidenca 5.13</i>). Neni 6 i kësaj rregulloreje, Mbrojtja e Diplomës me temë për studentët me notë mesatare mbi 8 dhe me provim përfundimtar për pjesën tjetër, kjo rregullore përcakton qarte rregullat e posaçme të mbrojtjes së diplomës me temë. Studentët e programit të studimit kishin filluar procedurën e temës së diplomës në fillim të semestrit të dytë. Dokumenti udhëzues mbi punimin e diplomës, jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet për temën e diplomës. Sipas RVB ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome (<i>Evidenca 3.31</i>).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli	Përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik, përfshirë edhe diplomimin e studentëve, është njësia bazë, Departamenti i Matematikës

<p>akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>së Aplikuar. Kjo njësi harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një fond pyetjesh orientuese për studentët për përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar të diplomimit. Fond pyetjesh që u vihen studentëve në dispozicion në zyrën e informimit pranë njësisë kryesore (<i>Evidenca 3.31</i>). Gjithashtu, për studentët që plotësojnë kriterin minimal të notës mesatare të ponderuar jo më pak se 8, u jepet mundësia e zhvillimit të punimit të diplomës në formë projekti. Edhe në këtë rast, studentëve u shpërndahet udhëzuesi për punimin e diplomës së bashku me temat e mundshme që studenti mund të zgjedhë për të zhvilluar.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloret e institucionit, GVJ konstaton se Teza e Provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve (<i>Evidenca 5.13, Evidenca 3.31</i>). Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i provimit përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtarë bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar apo përgatitjen e punimit të diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor. në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik (<i>Evidenca 1.20</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit si dhe në udhëzuesin e punimit të diplomës, për këtë program studimi, punimi i diplomës jo domosdoshmërisht duhet të ketë punim praktik, në rastet kur tema përfshin një fushë të tillë departamenti mbështet realizimin e punimit praktik të temës së diplomës. Mbështetja përfshinë edhe vënien në dispozicion të studentit ambientet laboratorike nëse është e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar (<i>Evidenca 5.13, Evidenca 3.31</i>). Ai garanton cilësinë e rezultateve, originalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Procedura e diplomimit për studentët e këtij institucioni është e hartuar qartë në rregulloret e ndryshme që janë hartuar në nivel institucioni, njësie kryesore dhe asaj bazë (<i>Evidenca 5.13</i>).</p>

	<p>Provimi përfundimtar ose projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomës</p> <p>Vlerësimi behet në bazë të vlerësimeve të pavarura të anëtareve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidati dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të bëra nga komisioni. Nota komunikohet në prani të komisionit nga kryetari i komisionit .</p> <p>Ne rastin e provimit përfundimtar nota del pas vlerësimit të çdo tematike nga anëtari i komisionit përgjegjës për fushën përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS zyrtar përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma mbart elementët e përcaktuar dhe miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe lëshohet vetëm njëherë nga institucioni. Institucioni mban kopje të saj dhe studenti mund të pajisjet vetëm me vërtetime në rast humbjeje të saj. Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar kur ai e kërkon këtë gjë (<i>Evidenca 2.3</i>).</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Ky material mund të jepet edhe në gjuhën angleze, fakt që ndihmon studentin kur shkon jashtë shtetit për studime ose punësim.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizimi i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment (<i>Evidenca 3.36</i>). Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor de administrativ.</p>	<p>Në bazë të organogramës së FSHN, dy njësitë përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit është Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës (<i>evidenca 1.12</i>). Gjatë vizitës në Institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi që disponohet dosje e plotë për çdo personel akademik të brendshëm (fleta prezantuese e dosjes teknike, CV, kontratë pune, diplomat e arsimimit të të gjithë cikleve, lista e notave, dëshmitë e gjuhëve të huaja, librezë e punës, shkresa e emërimit, librezë pune etj. (<i>evidencë 4.26, evidencë 4.27, evidencë 1.13, evidencë 1.16b</i>). Në çdo fillim viti hartohet tabela e ngarkesës individuale për çdo semestër dhe vjetore, e detajuar me të gjithë elementet e udhëzimit 29, datë 10.09.2018 (<i>evidencë 4.2</i>) lidhur me orët brenda dhe jashtë auditorit (udhëheqje diplomash, doktoratash, juri etj.) (<i>evidencë 4.1</i>). Hartohen tabelat e realizimit të ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë programit bachelor, nga personeli akademik i brendshëm efektiv (PAE) dhe te pjesshëm/ ftuar (PAK) të detajuara me lëndët/modulet dhe orët për çdo semestër (<i>evidencë 4.3, evidencë 4.4, tabela 12, tabela 4 ASCAL</i>). Çdo element i përmendur për këtë kriter është i shoqëruar me evidencën përkatëse dhe të plotësuara në mënyrë korrekte.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura dhe verifikimi në Institucion, Departamenti zbaton procedura të përcaktuara qartë për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të sanksionuara në Statut, Rregullore të UT dhe në kornizën ligjore në fuqi. (<i>evidencë 1.1, neni 14, 67, 68, 69, evidencë 1.5, nenet 25, 26, evidencë 1.22, evidencë 4.7, evidencë 4.28, evidencë 4.29</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>UT dhe në veçanti Departamenti i Matematikës së Aplikuar zbaton procedura dhe kriteret të posaçme për rekrutimin e personelit akademik të përshkruara në Statut, Rregullore UT dhe Rregullore të DMA të cilat bazohen tek konkurrimi dhe të bëra publike në faqet web dhe në APP (<i>evidencë 1.1, neni 14, 67, 68, 69, evidencë 1.5, nenet 25, 26, evidencë 1.22, evidencë 4.5, evidencë 4.6, evidencë 4.28, evidencë 4.29</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të</p>	<p>Departamenti i Matematikës së Aplikuar ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi për personel akademik të parashikuara në detaje në kornizën ligjore të UT/FSHN/DM (<i>evidenca 1.1, neni 67, evidencë 1.22, evidenca 4.28, evidencë 4.29</i>). Këto procedura konkurimi garantojnë transparencë dhe meritokraci. Në përfundim të procesit personeli akademik i rekrutuar nënshkruan kontratë pune të rregullt me UT bazuar në kornizën ligjore në fuqi, e cila gjendet në dosjen</p>

kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

personale në Burimet Njerëzore (*evidencë 4.7, evidencë 4.26, evidencë 4.29.1*). Personeli akademik që mbulon Programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” ka kualifikimin në nivelin e duhur (*tabela 1, tabela 6 ASCAL*).

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	3
Prof. Asoc.	3	2
Dr./PhD	7	1
Dr. Proces	0	0
Msc.	1	5
Total	12	11

Konkretisht, gjatë 2021-2022, vetëm në Programin e Studimit Bachelor ne Matematike kontribuojnë (*Tabela 6 ASCAL*):

Kualifikimi	PAE	PAK:
Prof. Dr.	1	2
Prof. Asoc.	9	2
Dr./PhD	13	4
Msc.	5	6
Gjithsej	28	14

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke shqyrtuar infrastrukturën ekzistuese në të cilën kryen veprimtarinë e vet Departamenti i Matematikës së Aplikuar, konstatohet një infrastrukturë e përshtatshme për çdo personel akademik duke siguruar barazi por edhe komoditet të mjaftueshëm që do të garantonin plotësisht cilësinë dhe performancën në kryerjen e veprimtarisë akademiko-shkencore të çdo anëtari të personelit akademik të Departamentit të Matematikës të Aplikuar (<i>evidencë 1.11, evidencë 4.8, evidencë 4.8.1, evidencë 4.9, evidencë 4.10, evidencë 4.16</i>).
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga evidencat e paraqitura, rezulton se Departamenti i Matematikës së Aplikuar në kuadër të strategjisë së zhvillimit të UT (<i>evidencë 1.2</i>), planit të kërkimit shkencor të zhvillimit të UT, planit strategjik të programit të studimit (<i>evidencë 1.4</i>) ka krijuar mundësitë që personeli akademik, të kryejë mobilitete për trajnim/ mësimdhënie apo dhe kontribute të tjera në kuadër të programeve ERASMUS etj. (<i>evidencë 2.20, evidencë 2.19, evidencë 4.11°, evidencë 4.11b, evidencë 4.12</i>).

	<p>Gjithashtu sigurohet edhe mbështetje financiare për aktivitete botuese apo referuese në veprimtari shkencore jashtë vendit, sidomos të personelit që aspirojnë titull akademik (<i>evidencë 4.13, evidencë 4.14, evidencë 4.15, evidencë 1.26, evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10</i>).</p> <p><i>Procedura e financimit të veprimtarive botuese apo referuese që menaxhohet në rang fakulteti është e qartë por mund të përmirësohet për të siguruar optimizim të fondit me qëllim rritjen e mbështetjes të sa më shumë veprimtarive kërkimore të personelit akademik.</i></p> <p>Departamenti i Matematikës së Aplikuar është pjesmarrës në projektin “The power- shkenca e te dhënave dhe teknologjia” (https://fshn.edu.al/notifications/the-power-shkenca-e-te-dhenave-dhe-teknologjia, <i>evidencë 1.32.1</i>) i cili synon ofrimin e trajnimeve për studentët e nivelit bachelor, master dhe doktorantë të institucionit (FSHN, UT), lektorë dhe kërkues shkencor pranë institucionit. Departamenti ka patur dhe pjesëmarrje dhe bashkëpunime në kuadër projektsh të tjera (<i>evidencë 1.31</i>).</p> <p>Personeli akademik angazhohet për kualifikimin e tyre (<i>tabela 1, tabela 4 ASCAL, evidencë 1.14</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Departamenti i Matematikës së Aplikuar si pjesë integrale e UT, rezulton eficient në përdorimin e metodave inovatore të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e reja, siç ishte rasti i përdorimit të tyre gjatë mësimdhënies dhe kryerjes së provimeve «on-line» në distance gjatë kohës së pandemisë së COVID-19 (<i>evidencë 3.2, evidencë 3.3, evidencë 3.4</i>). Ky proces është i sanksionuar dhe i inkuadruar në Udhëzues dhe Rregullore zyrtare të miratuar të UT (<i>evidencë 3.2, evidencë 3.4, evidencë 4.23, evidencë 4.24</i>). Gjithashtu UT mbështet iniciativat kërkimore-shkencore të personelit nëpërmjet financimit të projekteve konkurruese të personelit akademik (<i>evidencë 3.1</i>). Në mbështetje të përdorimit të metodave të ndryshme inovatore të mësimdhënies është laborator i Inxhinierisë Matematike dhe Informatike i kompletuar (<i>evidencë 1.11, evidencë 4.9, evidencë 4.10</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Për të përmbushur objektivat e Programit të studimit, Departamenti i Matematikës së Aplikuar kryen një organizim dhe shpërndarje të ekuilibruar të ngarkesës mësimore në auditor dhe asaj kërkimore sipas kualifikimit të çdo personeli akademik, duke shmangur mbingarkesat (<i>evidencë 4.1</i>). Respektohet komiza ligjore në fuqi që ngarkesa të jetë deri në 200 orë mbi normën vjetore sipas kualifikimit përkatës. Gjithashtu kjo realizohet edhe me bashkëpunimet me personelin akademik të Departamenteve të Matematikës, Fizikës, Informatikës, Matematikës së Aplikuar, Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve që kontribuojnë në këtë program studimi (<i>Tabela 12 ASCAL</i>).</p> <p>Nga evidentimi i bërë ngarkesës mësimore, konstatohet:</p> <p><u>Viti akademik: 2018-2019</u></p> <p>TOTALI: 2561 orë</p> <p>PAE (5 Prof. Asoc. Dr, 1 Prof. Dr, 8 Dr, 4 Msc, 2 Dr. Proc.)</p> <p>PAK (7 Msc, 1 Dr. Proc., 4 Dr, 1 Prof. Dr, 1 Prof.asoc.)</p>

Raporti PAE/ PAK: 1752/809 (68.4 %/31.6 %)

Shënim: 423 orë nga 809 orët e mbuluara nga PAK janë orë që i takojnë Informatikës dhe që Departamenti i Informatikës i ka mbuluar me PAK.

Në këtë vit akademik, ngarkesa mësimore e mbuluar nga stafi PAE, ka qenë (68.4%) më e vogël se 70% në total të orëve.

Për analizën e më sipërme, institucioni ka paraqitur komentimin numër 4 për të shpjeguar dhe arsyetuar që realisht ngarkesa mësimore e mbuluar për çdo student, është brenda kuadrit ligjor me së paku 70% e ngarkesës e mbuluar nga staf PAE.

Duke sqaruar se ngarkesa specifike për çdo student, edhe në këtë vit është në masë më të madhe se 70% me staf PAE. Kjo pasi raporti i mësipërm merr në konsideratë orët totale për të gjitha grupet e leksioneve dhe seminareve.

Nëse i referohemi me një shembull të thjeshtë: një lëndë me një total 60 orë në auditor të ndara me 42 orë leksione në auditor të zhvilluara nga staf PAE, dhe 18 orë seminare të zhvilluara nga staf PAK, nëse është vetëm një grup seminari, raporti është 70% PAE (42/60) dhe 30% PAK (18/60). Në rastin konkret, për këtë program studimi, në atë vit akademik kanë qenë më shumë se një grup seminari, por një grup i vetëm leksioni. Nëse kemi një grup leksioni, por dy grupe seminari për këtë lëndë, si raport i paraqitur në tabelat e RVB, janë 42 orë leksione PAE dhe 18+18 orë seminare PAK duke ndryshuar raportin tashmë 54 % PAE (42/ 78) dhe 46 PAK (36/78). Por secili student, ka ndjekur leksionet me staf PAE dhe seminarin përkatës me staf PAK, pra, edhe në këtë rast, secili student, ka ndjekur aktivitetin didaktik në raportin 70% PAE dhe 30 % PAK. Referuar edhe VKM 41 dhe standardeve të cilësisë, flitet për mbulimin e orëve për të njëjtët studentë në masën së paku 70% nga PAE.

GVJ, në analizën e të dhënave tabelare, të paraqitura për vlerësimin e jashtëm, nuk e kishte të plotë këtë informacion për të gjykuar mbi fenomenin global të mbulimit të ngarkesës për një vit akademik në raportin 68.4%/31.6%. Megjithatë, arsyetimi i paraqitur nga institucioni konfirmohet edhe me numrin e grupeve mësimore të paraqitura në tabelat në RVB, si dhe me qëndrueshmërinë e stafit PAE të përfshirë në këtë program studimi.

Për sa më sipër, komenti i paraqitur nga institucioni qëndron, dhe vlerësimi i paraqitur në draft raport ndryshon duke mos qenë kjo mospërputhje në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Viti akademik: 2019-2020

TOTALI: 2535 orë

PAE (5 Prof. Asoc. Dr, 1 Prof. Dr, 11 Dr, 5 Msc, 3 Dr. Proc.) PAK (4 Msc, 3 Dr, 1 Prof. Dr, 1 Prof. Asoc. Dr)

Raporti PAE/ PAK: 2208/327 (87.1%/12.9%).

Viti akademik: 2020-2021

	<p>TOTALI: 2516 orë PAE (10 Dr, 7 Prof. Asoc. Dr, 1 Prof. Dr, 5 Msc, 1 Dr. Proc.) PAK (3 Dr, 3 Msc, 2 Prof. Dr, 1 Prof. Asoc. Dr). Raporti PAE/ PAK: 2188/328 (87%/13%).</p> <p>Viti akademik: 2021-2022 TOTALI: 2516 orë PAE (11 Dr, 7 Prof. Asoc. Dr, 1 Prof. Dr, 5 Msc) PAK (2 Prof.dr., 3 Msc, 1 Prof. Asoc. Dr, 3 Dr) Raporti PAE/PAK: 2188/328 (87%/13%). Në këtë mënyrë respektohet raporti i duhur i kërkuar nga korniza ligjore. Në dispozicion ka dhe një personel ndihmës-akademik të vetin, por edhe mbështetjen e personelit të specializuar të FSHN për shërbime të caktuara (<i>evidencë 1.11, evidencë 1.12, evidencë 1.15</i>).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Matematikës së Aplikuar si pjesë integrale e FSHN zhvillon procesin mësimor në 4 godina që disponon ky fakultet. Duke parë evidencën e shpërndarjes, rezulton se hapësirat në dispozicion të realizimit të procesit mësimor (leksione dhe seminare) janë të mjaftueshme dhe të pajisura mjaftueshëm nga pikëpamja infrastrukturore në dispozicion të studentëve sipas natyrës së moduleve respektive (<i>evidencë 4.8, evidencë 4.8.1, evidencë 1.11</i>).</p> <p><i>Është e nevojshme sigurimi i një salle laboratorit kompjuterik në dispozicion vetëm të studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike, në mesin C ku zhvillohen kryesisht veprimtaritë e këtij programi. Laboratori i Inxhinierisë Matematike ekzistues (<i>evidencë 4.9</i>), përdoret kryesisht për studentët e Masterit ose për orë aplikative të disiplinave matematike. Nga takimi me studentët rezultoi që disiplinat informatike zhvillohen kryesisht në klasa me dërrasë të zezë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes</p>	<p>Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion dhe bazuar në evidencat e infrastrukturës reale në dispozicion të procesit mësimor teorik dhe praktik, konstatoi mjaftueshmërinë e hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që sigurojnë kryerjen me efektivitet të llojeve të</p>

<p>përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>aktivitete mësimore që parashikohen sipas natyrës së moduleve (<i>evidencë 4.8, evidencë 4.8.1, evidencë 1.11</i>). Njëkohësisht edhe hapësira në dispozicion të personelit akademik është mëse e mjaftueshme qoftë nga pikëpamja fizike ashtu dhe ajo infrastrukturore (<i>evidencë 4.10, evidencë 4.16, evidencë 4.20</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Duke u nisur nga natyra konkrete e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike", ambientet e nevojshme për të realizuar objektivat e këtij programi, janë kryesisht për leksione dhe seminare. Ndërsa për disiplinat që kanë të nevojshme pajisje laboratorike për zbatimet kompjuterike, në dispozicion, është laborator i matematikës i pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për të realizuar objektivat e këtyre disiplinave (<i>evidenca nr. 4.9, evidenca nr. 1.11, evidencë 4.20</i>), i cili falë investimeve është në përmirësim të vazhdueshëm, siç rezulton edhe nga evidencat e burimeve financiare të kushtuara për këtë qëllim (<i>evidenca 4.17, evidencë 4.18, evidenca 4.19</i>). Ky laborator përdoret kryesisht për studentët e Masterit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Matematikës së Aplikuar ka në dispozicion laboratorin e Inxhinierisë Matematike dhe Informatike të pajisur me infrastrukturën e nevojshme të teknologjisë informacionit, hardware dhe atë software në shërbim të objektivave të aktiviteteve mësimore të disiplinave specifike që kërkojnë një infrastrukturë të tillë (<i>evidenca nr 1.11, evidenca nr 4.9, evidencë 4.20</i>). Ky laborator përdoret kryesisht për studentët e Masterit. <i>Është i nevojshëm dhe një sallë tjetër laborator kompjuterik në dispozicion të studentëve bachelor. Nga takimi me studentët rezultoi që disiplinat informatike zhvillohen kryesisht në dërrasë të zezë.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Programi i studimit nuk parashikon praktikë profesionale të mirëfilltë, por parashikon në planin mësimor disiplinën <i>Njohje me Profesionin</i>. Në këtë kuadër Departamenti i Matematikës së Aplikuar ka lidhur disa marrëveshje të drejtpërdrejta bashkëpunimi me disa kompani si dhe shfrytëzon dhe marrëveshjet me FSHN/UT, që studentët të kenë mundësi për praktika apo internshipe (<i>evidencë 1.26, evidencë 1.29, evidencë 2.24</i>). Një rëndësi të vecantë paraqet bashkëpunimi me Institutin e Modelimeve në Biznes (<i>evidencë 1.29, evidencë 5.25</i>). Kurse për veprimtaritë praktike që parashikohen në disiplina të veçanta, që kanë të bëjnë kryesisht me përdorimin e software-ve matematikë në zbatime të ndryshme, departamenti ka në dispozicion laboratorin e Inxhinierisë Matematike dhe Informatike të pajisur me infrastrukturën e nevojshme të teknologjisë informatike. Gjithashtu në dispozicion është dhe biblioteka e FSHN (<i>evidencë 4.8.3</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në Institucion e GVJ, u konstatua që në dispozicion të studentëve është biblioteka e FSHN. Kjo bibliotekë ofron ambientet e nevojshme fizike për të përballuar një frekuentim mesatar ditor rreth 140 studentë e pedagogë. Gjithashtu ajo ofron komoditet në ajrim dhe ngrohje. Është e pajisur me fond të pasur zërash, duke ofruar literature hardcopy dhe online. Kjo bibliotekë funksionon me dy turne dhe në mbështetje të saj ka një numër stafi të mjaftueshëm për të përballuar frekuentimin ditor (<i>evidencë 4.8, evidencë 4.8.3</i>).
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ofron në total rreth 80018 tituj: tekste mësimore universitare, disertacione, revista dhe periodikë shkencore në shqip dhe në gjuhë të huaj. Gjatë vizitës në Institucion, konstatohet një mbulim i të gjithë disiplinave të programit mësimor me literaturën bazë, dhe me ato të rekomanduara të cilat janë disponibël në bibliotekë (<i>evidencë 4.8, evidencë 4.21, evidencë 4.22</i>).
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Konstatohet që studentëve ju sigurohet akses i barabartë dhe pa pagesë në bibliotekat online, sic është ajo Ulibrary dhe disa të tjera biblioteka digjitale dhe platformë online që ofrojnë literaturë në gjuhë të huaj JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM, MSP (<i>tabela 17 ASCAL</i>) në të cilat mundësohet akses elektronik i studentëve dhe pedagogëve nëpërmjet llogarive personale. Edhe nga biseda e GVJ me studentët u konstatua ky realitet. Digjitalizimi i bibliotekës së FSHN është në proces. Me përfundimin e këtij procesi, do të sigurohet akses më komod dhe i plotë për studentët. Gjithashtu në proces është edhe rrjeti për t'u pajisur me internet. <i>Sallat në dispozicion të studentëve duhet të pajisen me pc dhe sinjal wifi.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka në dispozicion të studentëve aktualisht ka 2 kompjutera me akses në internet dhe për shfrytëzimin e burimeve online, të pajisura me programet e nevojshme kompjuterike (<i>evidencë 4.8</i>). <i>Ndoshta kjo sasi është disi e vogël për të përballuar fluksin e studentëve në ditë. Duhet të rritet sasia e pc në bibliotekë dhe mbulimi me wifi.</i>

	Studentët mund të përdorin edhe mjediset e Laboratorit të Inxhinierisë Matematike dhe Informatike kur ai është i lirë.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Konstatohet që UT/ FSHN aplikon për çdo vit një procedurë duke filluar nga propozimi i njësisë bazë për pasurimin e fondit ekzistues me tituj të rinj: libra, abonime online etj (<i>evidencë 4.17, evidencë 4.18, evidencë 4.19</i>).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Rezulton që biblioteka është në dispozicion të studentëve në dy turne 8.00-20.00 në 5 ditët e punës javore, mbështetur edhe nga staf administrativ përkatës (<i>evidencë 4.8.3</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nota	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga evidencat dhe vizita në Institucion, rezulton që Sekretaria Mësimore e FSHN si detyrim ligjor të Ligjit të arsimit të lartë Nr. 80/2015 dhe rregullores së UT, administron gjithë informacionin që lidhet me studentët: regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike të studentëve, të cilat arkivohen në arkivat e shtetit dhe në funksion të këtyre administron: dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e provimeve dhe detyrimeve, dosjet e transferimit të studentëve, statistika të frekuentimit të studentëve, të studentëve që ç'regjistrohen, dosjet e diplomimit etj (<i>evidencë 3.34, evidencë 3.35, evidencë 3.36, evidencë 5.19</i>). Të gjitha këto arkivohen në arkivin e sekretarisë mësimore dhe shërbejnë si bazë për dhënien e informacioneve zyrtare nga sekretaria. Është në proces ndërtimi i sistemit të ri elektronik për administrimin e të dhënave për studentët i cili është mëse i nevojshëm. Nuk rezultoi të kishte transferim studentësh në periudhën e vlerësuar për të parë një dosje transferimi të studentëve në këtë Programit studimi (<i>evidencë 1.17, evidencë 2.21</i>).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin	Nga evidencat e paraqitura dhe vizita në Institucion, rezulton që Dega e Burimeve njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës, janë sektorët që administrojnë gjithë informacionin e duhur për

<p>dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>personelit akademik (efektiv dhe me kontratë), ndihmës akademik dhe administrativ, informacion ky që konsiston nga i gjithë dokumentacioni lidhur me arsimimin, përparimin akademik, procedurat e punësimit dhe kontratat e punës së secilit (<i>evidencë 1.13, evidencë 1.14, evidencë 1.15, evidencë 1.16, evidencë 1.22, evidencë 4.26, evidencë 4.27, evidencë 4.28, evidencë 4.29, evidencë 4.29.1</i>). Këto të dhëna përditësohen vazhdimisht në varësi të përparimit të secilit, sipas aktivitetit përkatës.</p> <p><i>Mungonin lejet e universitetit nga vjen për personelin akademik me kohë të pjesshme. Është detyrim ligjor që duhet të kërkohet dhe të ndodhet në dosjen e personelit përkatës akademik me kohë të pjesshme të aktivizuar në këtë program studimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas evidencës së paraqitur, rezulton që sistemi i menaxhimit siguron akses studentëve dhe personelit akademik, i cili është konfidencial në respekt të ruajtjes së të dhënave personale dhe mundësohet nëpërmjet llogarive personale. Studentët kanë në dispozicion portal elektronik nëpërmjet aksesit individual në të cilin ai kryen regjistrimin për kurset që do të frekuentojë, njohjen me rezultatet në provime etj. Gjithashtu në faqen zyrtare elektronike, studenti nëpërmjet aksesit individual mund të sigurojë faturat për tarifën e studimit, listë notash, certifikata apo dhe programet mësimore. Akses elektronik i sigurohet edhe personelit akademik, ndihmës akademik dhe sekretarisë mësimore (<i>evidencë 4.31</i>).</p> <p><i>Akresi ekzistues për t'u regjistruar në provime është nëpërmjet një Google form rezultatet e të cilit administrohen më pas nga sekretaria. Është i nevojshëm një sistem elektronik më dinamik dhe i plotë, ku pedagogët të deklarojnë detyrimet dhe vlerësimet e studentëve dhe nga i cili studenti jo vetëm të kryejë regjistrimet për provime por të marrë edhe shërbime të tjera lidhur me arritjet e tij akademike. GVJ konstatoi, që ky sistem është në përfundim për të filluar zbatimin në fillim të vitit akademik 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga GVJ u konstataua që midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv. Ky komunikim realizohet kryesisht fizikisht gjatë orës mësimore por edhe jashtë saj në ambientet (zyrat) përkatëse të pedagogëve (me emrat përkatës të tyre të shkruar në tabela), por edhe në mënyrë elektronike nëpërmjet e-mailit (sistemi mundëson adresat personale me domain të unifikuar të institucionit si për student ashtu dhe për personelin akademik). Gjithashtu komunikimi është edhe në plan tjetër, duke përdorur platformat online TEAMS ku kryhet komunikimi i vazhdueshëm lidhur me disiplinat përkatëse që mbulon çdo personelin akademik (<i>evidencë 4.23, evidencë 4.24</i>). Ky komunikim vazhdon aktiv edhe pas zhvillimit on-line të mësimit. Gjithashtu, komunikimi kryhet edhe në nivel tjetër, nëpërmjet faqeve elektronike zyrtare të FSHN lidhur me informacione të detajuara për njoftime të ndryshme lidhur me aktivitete që zhvillohen, mobilitete në kuadër të programeve europiane, tarifa të studimit,</p>

	informacione të detajuara lidhur me strukturën e vitit akademik dhe të dhëna për fakultetin etj. Njëkohësisht, komunikim kryhet edhe nëpërmjet faqes së Departamentit, në të cilën janë të detajuara edhe të dhënat për secilin nga personeli akademik. Në përgjithësi, i gjithë personeli ka paraqitur të dhëna lidhur me arsimimin, titujt, botimet dhe disiplinat që mbulon. Gjithashtu, në ambientet e Godinës C, gjendet dhe stenda zyrtare ku afishohen njoftime të ndryshme lidhur me orarin mësimor, orarin e provimeve, rezultate dhe njoftime të ndryshme me interes për studentin (<i>evidencë 4.30</i>).								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi i menaxhimit siguron adresa personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal (<i>evidencë 4.31</i>). Gjithashtu, në dispozicion është platforma TEAMS, faqet zyrtare të UT dhe FSHN ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë (<i>evidencë 4.23, evidencë 4.24</i>).								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UT, faqes elektronike të FSHN si dhe asaj të departamentit, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor dhe syllabuset e çdo disiplinë. Konstatohet që syllabuset e shkurtuara janë të paraqitura në faqe të departamentit. Japin informacion lidhur me objektivat e lëndës, konceptet themelore, strukturën e disiplinës si dhe mënyrën e vlerësimit. <i>Do të sugjerohet që në të ardhmen të mund të ndërtohet një Udhëzues Studimesh (pdf) për programin e studimeve me gjithë informacionin e nevojshëm: planin mësimor, syllabuset, personelin akademik, adresa komunikimi, detyra dhe të drejta të studentëve, rregulla të ndryshme etj. ku studenti do të gjejë çdo informacion që i duhet dhe i cili të jetë në faqen web.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e	GVJ konstatoi edhe nga biseda me grupet përkatëse se ekziston një procedurë plotësisht e përcaktuar e propozimit dhe miratimit të buxhetit vjetor dhe afatmesëm të institucionit ku përfshihet edhe ajo e departamentit, e cila mbulon kostot e programit të studimit dhe nevojave për mbështetje financiare për aktivitete botuese (<i>evidencë</i>

<p>programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>4.17, evidencë 4.18, evidencë 4.19, evidencë 4.33, evidencë 4.34, evidencë 4.35). Kjo procedurë fillon që nga njësia bazë dhe në mënyrë progressive në nivelet më lart Fakulteti dhe gjithë universiteti dhe është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (evidencë 1.23, evidencë 4.33). Informacionet/raportet për buxhetin publikohen nga FSHN. Plani financiar është i detajuar sipas gjithë zërave në mbështetje të shpenzimeve operative infrastrukturore dhe ato të mbështetjes së veprimtarive mësimore-shkencore (evidencë 4.17, evidencë 4.18, evidencë 4.19, evidencë 4.35).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit rezulton të përfshijë gjithë financimet e burimeve njerëzore që i shërbejnë realizimit të programit, si ato për shpenzime operative, edhe ato për abonimet online, pasurimin e bibliotekës, mbështetje për botimet shkencore etj. Plani financiar është i detajuar sipas gjithë zërave në mbështetje të shpenzimeve operative infrastrukturore dhe ato të mbështetjes së veprimtarive mësimore-shkencore (evidencë 4.17, evidencë 4.18, evidencë 4.19, evidencë 4.35, evidencë 4.36, evidencë 4.37).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Auditimi i gjendjes së financimit dhe efektiviteti financiar të institucionit përveç organizmave të auditit të KLSH dhe MAS, ka dhe sektorin e auditit të brendshëm nën varësinë e Bordit të Administrimit i cili kryen në mënyrë periodike auditimin dhe raporton përpara Bordit të Administrimit. Raportet financiare përmbajnë në mënyrë të hollësishme situatën financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare sipas zërave të aktiviteteve dhe sipas departamenteve (evidencë 4.32).</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Rezultoni që raportet dhe analizat financiare të hartuara nga universiteti në fund të çdo viti dhe për vitet akademike paraardhëse, ruhen në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivë-prokollin. Planifikimet dhe ndërhyrjet e posaçme parashikohen në buxhetet afatmesme për të garantuar mbarëvajtjen normale të programeve të studimeve (evidencë 4.32, evidencë 4.36).</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Me miratimin e buxhetit nga Bordi i Administrimit, si një përmbledhje e harmonizuar e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e të gjithë strukturave të universitetit në mbështetje të plotë të nevojave të gjithanshme për realizimin e misionit dhe objektivave të universitetit në tërësi dhe programeve të studimit në veçanti, garantohej qëndrueshmëria financiare e gjithë periudhës së zhvillimit të programit të studimit (<i>evidencë 4.17, evidencë 4.18, evidencë 4.19, evidencë 4.37</i>). UT rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (grantet e MAS, të ardhurat nga studentët dhe të ardhura nga shërbime për të tretë etj) ekzistuese për të realizuar objektivat e tij (<i>tabela 18 ASCAL</i>).</p> <p><i>Duhet të shtohen akoma më tepër zërat financiare për mbështetje të veprimtarive botuese të personelit akademik si dhe për të organizuar dhe mbështetur veprimtari të përbashkëta shkencore me studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Rezultoni që pranimit i studentëve kryhet mbi bazën e procedurave të parashikuara nga korniza ligjore në fuqi dhe mbi bazën e kuotave të miratuara nga MAS. E gjithë procedura e propozimit të kuotave, miratimit të tyre, procedurat e përzgjedhjes së tyre, rregullat e vlerësimit dhe frekuentimit, rregullat e kalimit nga një vit në tjetrin, të transferimit të tyre, ndjekja e një program të dytë studimit, të diplomimit të tyre, janë të sanksionuara në Statutin e UT, Rregulloret e UT, FSHN, DMA dhe programit të studimit (<i>evidencë 1.1, evidencë 1.5, evidencë 2.2, evidencë 5.1, evidencë 5.8, evidencë 5.9, evidencë 5.10, evidencë 5.11, evidencë 1.18, evidencë 1.19, evidencë 4.8.2</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e pranimit në programin e studimit "Bachelor në Inxhinieri Matematik dhe Informatike" janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kuotat dhe kriteret pasi janë miratuar në fund nga MAS shpallen për të gjithë kandidatët studentë në të gjithë vendin. Mënyra e pranimit dhe regjistrimit kryhet në përputhje me aktet ligjore të lëshuara nga MAS për të gjithë kandidatët-studentë të vendit në çdo vit, duke respektuar gjithë instancat e përfshira në të që nga njësia bazë derisa shpallen fituesit nga FSHN pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit përkatës. Regjistrimi kryhet sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara nga MAS (<i>evidencë 1.1, evidencë 2.2, evidencë 5.9, evidencë 5.10</i>).</p> <p>Politikat dhe procedurat që kanë të bëjnë me përparimin e studentëve, frekuentimin e tyre, përfaqësimin e tyre në organet drejtuese etj. janë të rregulluara nëpërmjet dokumenteve zyrtare të UT, Statutit të UT, rregullores së UT, dhe rregullores së programit të studimit. Në to janë të pasqyruara qartë të drejtat dhe detyrat e studentëve, të cilat garantojnë barazinë ndërmjet tyre (<i>evidencë 1.1, evidencë 1.5, evidencë 2.2</i>).</p> <p>Gjithashtu barazia dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët, garantohet edhe nga elemente të tjerë të rëndësishëm informimi siç janë: faqja elektronike e FSHN, e departamentit, informimi nëpërmjet adresave personale elektronike për çdo student, pjesëmarrja e studentëve në këshillat studentore, në senat, në Bordin e Administrimit, në Komisionet e ndryshme të UT (<i>evidencë 1.1, nenet 40, 41, 42, 43, fq 27-28, evidencë 1.1, nenet 130-136, fq. 71-72</i>). Garantohet pjesëmarrja e studentëve në aktivitete shkencore dhe sociale (<i>evidencë 1.1, evidencë 5.2</i>).</p> <p>Ata informohen për mundësitë e reduktimit të tarifave të studimit sipas akteve ligjore, informohen në mënyrë të barabartë për mundësitë e mobiliteteve në programe të ndryshme europiane, kanë mundësi këshillimi me psikologun e FSHN (<i>evidencë 3.38, evidencë 5.4, evidencë 5.5</i>), kanë të përcaktuar për çdo vit studimi një Kujdestar</p>

	<p>Akademik dhe pjesmarrja në veprimtari të tjera akademike dhe sportive. (<i>evidencë 1.1. neni 125, pika 6, fq. 69, evidencë 1.1. neni 127, fq 70, evidencë 1.25, evidencë 1.1, nenet 22, 23, fq. 14, 15, evidencë 1.3, evidencë 1.20</i>), apo dhe pjesëmarrje në mobilitete Erasmus (<i>evidencë 5.16</i>). Në nivel institucional është ngritur Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët (<i>evidencë 1.27, evidencë 1.28</i>).</p> <p>Gjithashtu, informacione të mjaftueshme për veprimtaritë e mësipërme gjenden në faqen web të Ut, FSHN dhe Departamentit.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Lidhur me kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve, që nga përcaktimi dhe miratimi i kuotave dhe kriterëve për një program studimi, UT/FSHN përveç procedurave të unifikuara dhe të sanksionuara në aktet ligjore të Qeverisë dhe MAS të Republikës së Shqipërisë, të cilat bëhen transparente për publikun nga QASH dhe të cilat janë të pasqyruara edhe në dokumentat zyrtare ligjore të tij: Statuti, Rregulloret etj., kryen edhe procedura të tjera në shërbim të aksesimit sa më të gjerë për publikun: merret pjesë në ditët e informimit të maturantëve ku pedagogë të Departamentit të Matematikës së Aplikuar marrin pjesë për të informuar maturantët me procedurat, kriteret dhe informacione të tjera që lidhen me programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike; shpërndahen fizikisht dhe në faqen web (FSHN dhe DM) guidën dhe fletpalosjen e përgatitur me gjithë informacionet e nevojshme për maturantët (<i>evidencë 5.3, evidencë 5.6, evidencë 5.7, evidencë 5.14</i>).</p> <p>Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës pranë FSHN jep informacion mbi programet e studimit, mundësitë e punësimit dhe ofrojnë shërbimin e këshillimit. Kjo zyrë mbështet studentët për orientimin dhe këshillimin gjatë gjithë cikleve të studimit. Kjo degë, organizon “Javën orientuese” në javën e parë të vitit akademik si një javë orientuese dhe informuese për studentët e vitit të parë, ku studentët njihen me elementet e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij, me kurrikulën mësimore që ata do të zhvillojnë gjatë ciklit të tyre të studimit, me organizimin e institucionit, me të drejtat dhe detyrat e tyre, me jetën studentore etj. (<i>evidencë 5.3, evidencë 5.6, evidencë 5.7</i>).</p> <p>Për çdo vit akademik, Departamenti cakton dhe Kujdestarin Akademik si këshillues permanent i studentëve të vitit përkatës (<i>evidencë 1.20</i>). Informimi kryhet edhe nga çdo personel akademik përkatës i disiplinës përkatëse.</p> <p>Njëkohësisht studentët e marrin këtë informacion edhe ndërmjet dokumenteve zyrtare në faqen web të FSHN dhe Departamentit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Çdo vit akademik vendosen kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”. Kjo realizohet në bazë të procedurës së përcaktuar në Statutin e UT, në përgjigje të kërkesës së MAS, me propozim të Departamentit të Matematikës së Aplikuar, miratim të senatit të UT dhe vendim të MAS (<i>evidencë 1.1., neni 90, fq 56, evidencë 1.1, nenet 108, 109, fq. 64 dhe neni 112, fq 65,</i></p>

	<p><i>evidencë 5.8, evidencë 5.9, evidence 5.10, evidence 5.11, evidencë 1.18, evidencë 1.19, evidencë 4.8.2).</i> Këto kriteret të pranimit publikohen në faqen zyrtare të UT, FSHN dhe Departamentit të Matematikës së Aplikuar, si dhe shpërndahen nëpërmjet broshurës “Mbi programet e studimit dhe kriteret e pranimit” dhe fletpalosjes”. Kriteret e pranimit” tek maturantët.</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Duke parë procedurën e ndjekur në bazë të evidencave përkatëse, konstatohet se institucioni në hartimin dhe zbatimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, ndjek plotësisht në mënyrë rigorozë gjithë hapat e parashikuara në aktet nënligjore në fuqi të çdo viti akademik të nxjerra nga MAS si dhe në përcaktimet dhe hapat ligjore të parashikuara në dokumentat zyrtare të UT: Statuti, Rregullore. Kuotat përcaktohen gjithmonë në përputhje me infrastrukturën reale ekzistuese duke siguruar cilësinë dhe standartet ligjore dhe duke respektuar gjithë kategoritë e njohura shoqërore të kandidatëve (brenda vendit, nga trojet, me aftësi të kufizuara, jetimet, shtetas të huaj, romë, kandidatë për transferim studimesh, kandidatë për programe të dyta studimi etj.) (<i>evidencë 5.8, evidencë 5.9, evidence 5.10, evidencë 1.1 neni 90, fq 56, evidencë 5.11, evidence 1.18, evidence 1.19).</i></p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në bashkëpunim me DRAP dhe ZVA, FSHN dhe Departamenti i Matematikës së Aplikuar, organizojnë me nxënësit – maturantë të shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë takime informuese në “javën e informimit”. (https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-firanes/)</p> <p>Në këto takime merr pjesë personeli akademik, të cilët informojnë në detaje dhe qartësojnë nxënësit – maturantë mbi të gjitha programet e studimit që FSHN ofron, si dhe mbi procedurat dhe kriteret për t’u regjistruar si student në secilin program studimi (<i>evidencë 5.6, evidencë 5.7, evidence 5.14).</i></p> <p>Informacionet për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit publikohen në website-in e FSHN (https://fshn.edu.al/Info/kriteret; https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/).</p> <p>Në faqet e FSHN dhe Departamentit të Matematikës së Aplikuar, gjenden dhe informacione publike në lidhje me programin e studimit, organizimin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore, etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga vizita në Institucion del që Departamenti i Matematikës së Aplikuar ofron informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Ky informacion gjendet i pasqyruar në Rregulloren e programit të studimit i cili është dhe i publikuar në faqen web (<i>evidencë 2.2, evidencë 5.13</i>). Gjithashtu, ky informacion jepet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet javës orientuese në fillim të studimeve. Informacioni jepet edhe nëpërmjet vetë personelit akademik për çdo disiplinë bazuar tek syllabusi i saj apo dhe nga Kujdestari Akademik i çdo viti që caktohet çdo fillim viti akademik për çdo vit studimi (<i>evidencë 1.1., neni 127, fq 70, evidencë 1.2</i>). Njëkohësisht, këto informacione që studenti i merr drejtpërsëdrejti apo dhe të tjera shtesë që lidhen dhe me infrastrukturën e FSHN, studenti mund ti marrë edhe nëpërmjet faqes web të FSHN dhe Departamentit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në bazë të evidencave të paraqitura, rezultojnë që ekziston një procedurë e përpiktë lidhur me kriteret dhe procedurat e transferimeve të studentëve dhe ekuivalentimeve të mundshme pas transferimit. I gjithë ky informacion gjendet në Statutin dhe Rregulloren e UT. Duke u mbështetur në këto dokumente ligjore, Departamenti i Matematikës së Aplikuar disponon një procedurë transparente dhe rigoroze për njohjen e studimeve të mëparshme (<i>evidencë 1.1 nenet 108, 109, fq. 64, evidencë 1.5, evidencë 1.1, neni 112, fq 65, evidencë 1.25, evidence 2.21, evidence 2.2, evidence 1.17</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Siç u konfirmua dhe nga vizita në Institucion, konstatohet që studentët informohen në mënyrë të detajuar lidhur të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë si nga personeli akademik përkatës ashtu edhe nga Kujdestari Akademik në mënyrë të drejtpërdrejtë, por këtë informacion ata mund ta marrin edhe nga Rregullorja e UT apo e Programit të studimit, apo syllabuset e disiplinave që gjendet në faqen web (<i>evidencë 1.5. neni 47, 48, evidencë 2.2, evidence 2.1</i>). Informohen në afatet e duhura në ambiente publike lidhur me kohën dhe oraret e provimeve (<i>evidencë 2.11</i>). Për të vlerësuar studentin me pikë, përdoren kryesisht aktivizimi dhe frekuentimi në auditor, testimi me shkrim apo dhe me gojë (<i>evidencë 2.1</i>). Pikët konvertohen në notë mbi bazën e intervaleve plotësisht të përcaktuara në Rregullore (<i>evidencë 2.2, evidencë 1.5</i>). Studentit i jepet mundësia të njihet me testin që ka shkruar, me pikët e çdo elementi në vlerësim dhe gjithashtu ka dhe të drejtën e ankimit në rast se lind nevoja në afatet kohore dhe me mënyrën e përcaktuar në Rregullore (<i>evidencë 1.5.neni 50, 51, evidencë 2.2</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rezultojnë që studentët e vitit të tretë informohen që në fillim të vitit akademik dhe gjatë tij, nga Kujdestari Akademik (<i>evidence 1.20</i>) dhe sekretaria mësimore për rregullat dhe programin e diplomimit. Gjithashtu ky informacion merret edhe nëpërmjet Statutit dhe Rregullores së UT, Rregulloren e programit të Studimit si dhe ekziston dhe Rregullorja e Diplomimit (<i>evidencë 1.1, neni 89, fq. 56, evidencë 1.5. neni 59, 60, 61, 62, evidencë 2.2, evidencë 3.25, evidencë 5.13</i>).</p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Nga evidencat përkatëse, rezulton që përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, në rang universiteti dhe fakulteti publikohen udhëzues të posaçëm, si broshura dhe fletëpalosje mbi kriteret e pranimit dhe informacione në lidhje me programin e studimit. Njëkohësisht, Universiteti i Tiranës, FSHN, në bashkëpunim me DRAP dhe ZVA dhe përfaqësues të departamentit të Matematikës së Aplikuar organizojnë takime me maturantët në shkollat e mesme kryesisht në periudhën Mars-Maj, që është periudha para plotësimit të formularëve të aplikimit të maturantëve. Kjo gjë bëhet edhe në panairin e universiteteve apo Ditët e hapura të informimit të maturantëve të organizuara në rrethe të ndryshme (<i>evidence 5.14, evidencë 5.6, evidencë 5.7</i>). Gjithashtu, gjithë ky informacion publikohet edhe në faqen web. (https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/) <i>Është e nevojshme një strategji më e mirë, më konkrete dhe më efikase se këto tradicionale për të promovuar programin e studimeve tek të gjithë maturantët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Rezulton që studentët informohen që në javën e parë të vitit akademik në Javën orientuese në mënyrë të hollësishme lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Këtë informacion e marrin edhe në vijim të vitit nëpërmjet Kujdestarit Akademik, zyra e këshillimit dhe karrierës edhe nga secili personel akademik (<i>evidence 1.6, tabela 9 ASCAL, evidence 1.5, evidence 1.20, evidence 2.1, evidence 2.2</i>). Njëkohësisht këtë informacion ata mund ta marrin edhe nga faqja web e FSHN dhe e Departamentit, ku ata mund të njihen gjithashtu edhe për infrastrukturën e ambienteve dhe shërbimet që merren prej tyre. Në mbështetje të studentëve për informacion është dhe sekretaria mësimore dhe dega e IT së FSHN. GVJ konstatoi nga biseda me ta, që studentët ishin të informuar për këto elemente.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Informacioni rezulton të merret në Javën Orientuese në javën e parë të vitit akademik, merret nga çdo titullar i disiplinës, i cili informon në detaje strukturën, përmbajtjen, frekuentimin, vlerësimin, kreditet, objektivat, veprimtaritë formuese dhe qëllimet. Këto detaje gjenden edhe në faqen web të Departamentit (<i>evidencë 2.2, evidence 2.1, evidence 5.6, evidence 5.7, evidence 1.6</i>). Studentë këto informacione mund ti marrin edhe nëpërmjet faqes web, nëpërmjet sistemit elektronik (<i>evidence 4.25, evidence 4.31</i>), ndërmjet sekretarisë mësimore dhe bibliotekës së FSHN (<i>evidencë 1.1</i>).</p>

	<p><i>Do të sugjeronim që në të ardhmen të mund të ndërtohet një Udhëzues Studimesh (pdf) për programin e studimeve me gjithë informacionin e nevojshëm: planin mësimor syllabuset, personelin akademik, adresa komunikimi, detyra dhe të drejta të studentëve, rregulla të ndryshme etj. ku studenti do të gjejë cdo informacion që i duhet dhe i cili të jetë në faqen web.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Rezulton që organizmi kryesor që merret me informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësinë e punësimit është “DSBCK” pranë FSHN. Ka dhe studime të tregut në rang universiteti (<i>evidencë 1.9</i>). Mbështetja institucionale është nëpërmjet këshillimit të DSBCK dhe nëpërmjet panairëve të karrierës apo punës të organizuara nga UT (<i>evidence 5.25, evidence 5.3</i>).</p> <p>Këtu ndihmon mjaft edhe marrëveshjet institucionale me kompani të ndryshme gjatë së cilës studentë kryejnë internshipe dhe kjo ndihmon studentët të shikojnë praktikisht ku mund të punësohen (<i>evidencë 1.26, evidencë 1.29, evidencë 2.24</i>). Departamenti i Matematikës së Aplikuar mjaft studentë të vetët në vite i ka punësuar si PAE dhe si personel ndihmës-akademik (<i>evidence 1.15</i>). Departamenti ka realizuar në nivel departamenti studim mbi tregun e punës mbi punësimin e studentëve në vite (<i>evidencë 1.9</i>). Pjesa më e madhe e studentëve vazhdojnë studimet e ciklit të dytë por edhe të tretë po pranë këtij departamenti por edhe jashtë vendit (<i>evidencë 2.18</i>). Pas studimeve ata punësohen në institucione publike dhe private. Duke gjurmuar studentët pas përfundimit të studimeve Bachelor, rezulton se ata zhvillojnë internshipe (<i>evidencë 5.15</i>) dhe njëkohësisht ata ndjekin studimet e ciklit të dytë pranë Departamentit apo dhe jashtë vendit (<i>evidencë 2.18, 2.20, evidencë 5.16, evidencë 5.17, evidencë 5.18</i>).</p> <p><i>Në këtë kuadër do të ndihmonte në qoftë se do të kishte praktikë profesionale në programin Bachelor, e cila nëpërmjet marrëveshjeve institucionale, do të ndihmonte studentët të shikonin praktikisht ku mund të punësoheshin.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Ka disa forma nëpërmjet të cilave studentët informohen për procesin mësimor dhe elementët e tij apo infrastrukturën dhe shërbimet prej saj që lidhen me procesin mësimor: nëpërmjet kujdestarit akademik, faqes web të fakultetit dhe departamentit, stendës informative në hollin e departamentit, platformave online të mësimdhënies (<i>evidencë 1.20, evidencë 4.30, evidencë 4.23, evidencë 4.24, evidencë 4.31</i>).</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Konstatohet që përdoren disa forma të informimit të studentëve për programin e studimit: nëpërmjet kujdestarit akademik, personelit akademik përkatës të çdo disipline, faqes web të fakultetit dhe departamentit, nga komunikimi elektronik nëpërmjet adresave e-mail me domain institucional dhe platformave online (<i>evidencë 3.2, evidencë 3.3, evidencë 3.4, evidencë 4.23, evidencë 4.24, evidencë 4.31, evidencë 2.2, evidencë 5.6, evidencë 5.7, evidencë 5.12</i>).</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Gjithë baza e të dhënave dhe statistikat përkatëse lidhur me studentet deri në diplomim, administrohen nga Sekretaria mësimore për të gjitha vitet. Dokumentacioni bazë konsiston në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomës. Këto të dhëna arkivohen mbi bazën e ligjit mbi arkivimin e dokumentacionit zyrtar (<i>evidencë 3.34, evidencë 3.35</i>).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Rezultoni që është sekretaria mësimore që administron gjithë dokumentacionin për çdo student të regjistruar të ç' regjistruar, të transferuar, të diplomuar, në program të dytë studimi, gjithë vlerësimet akademike të tyre, dhe mbi bazën e të cilave prodhohen statistikat apo dokumentacionet zyrtare për studentin, institucionin apo MAS (<i>evidencë 1.17, evidencë 2.21, evidencë 3.34, evidencë 3.35</i>).
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	<p>Sekretaria mësimore administron regjistrin themeltar të çdo studenti ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar gjithë arritjet akademike të tij, në çdo vit duke respektuar dhe duke u bazuar rregulloren e UT dhe rregulloren e programit të studimit (<i>evidencë 1.5, evidencë 2.2, evidencë 3.34, evidencë 3.3, evidencë 3.36</i>).</p> <p><i>Duhet sanksionuar si detyrim në rregulloren institucionale që personeli akademik të depozitojë në sekretarinë mësimore, si njësi përgjegjëse për administrimin e të dhënave të studentëve, në mënyrë zyrtare gjithë vlerësimet e pjeshme përpara provimit final, sidomos ato të cilat janë edhe penalizuese për hyrjen në provimin final apo dhe në sezonet më pas. Ky vlerësim duhet të ruhet nga sekretaria dhe të menaxhohet prej saj në sezonet e ardhshme të provimeve kur studentët të regjistrohen në provimin e këtyre disiplinave, dhe jo të ruhen nga vetë personeli akademik gjë që lë vend për abuzime.</i></p> <p><i>Nga realiteti u konstatua që studenti nuk pajiset me suplementin e diplomës kur ai diplomohet, por vetëm kur ai e kërkon. Sekretaria ka detyrim ligjor të pajisë studentët me suplementin e diplomës kur ata diplomohen sipas VKM 185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementët e</i></p>

	<p><i>programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar, Pika 1, gërma ç.</i></p> <p><u>Megiithatë, sugjerimi i më sipërm, nuk është kompetencë e stafit akademik apo e njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, por është përgjegjësi e rregulloreve në rang universiteti.</u></p> <p><u>Për sa më sipër, sugjerimi është i vlefshëm për tu analizuar në kuadër të akreditimit institucional dhe jo të këtij programi studimi.</u></p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Konstatohet se rezultatet e studentëve pasqyrohen në proces verbalet e provimeve të secilës lëndë nga pedagoget e tyre dhe njëkohsisht ato pasqyrohen edhe në databazën e Sekretarisë mësimore si edhe në Regjistrin themeltar (<i>evidencë 3.34, evidencë 3.35, evidencë 5.19, evidencë 5.20</i>). Rezultatit në provim studentit e merr nga pedagogu i lëndës përkatëse. Gjithashtu, i mundësohet në çdo moment aplikimi në pranë sekretarisë mësimore për vërtetim notash. Të dhënat në “Regjistrin themeltar”, në “Regjistrin e arritjeve akademike të studentëve” dhe në “Regjistrin e Diplomave” janë të sigurta dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Si një detyrim ligjor kundrejt MAS, UT-ja, mbi bazën e raporteve të fakulteteve harton Raportin Vjetor me të gjithë elementet përbërës të tij, në të cilin analizohet dhe vlerësohet, ndër të tjera, veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve që ofrohen. Raporti vjetor FSHN, i cili hartohet bazuar në evidencat dhe raportet e njësive bazë përmban profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Në këto raporte pasqyrohen edhe masat/rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Ndër treguesit bazë të cilësisë së mësimdhënies në analizë është mesatarja e shkollës së mesme tek të regjistruarit në program, si dhe kalueshmëria dhe cilësia e vlerësimit sipas lëndëve. Në raportet vjetore të departamentit paraqiten rezultate analitike mbi numrin e të regjistruarve, dhe të diplomuarve të programit të studimit (<i>evidencë 1.30, evidencë 5.21, evidencë 6.6, evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10</i>). Gjithashtu propozohen dhe masa/ rekomandime për përmirësime të procesit mësimor (<i>evidencë 6.12</i>). Departamenti duke marrë në konsideratë rënien e cilësisë në hyrje të studentëve, ka parashikuar kapituj zero në disiplina të ndryshme që përforcojnë njohuritë nga shkolla e mesme. Rezulton që pjesa më e madhe e studentëve, ndjekin ciklin e dytë të studimeve. Në këtë kuadër, ndoshta duhet menduar për të përfshirë në planin mësimor një disiplinë “Plotësime në Matematikë”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit të arsimit të lartë dhe Rregullores dhe Statutit të UT (<i>evidence 1.1, neni 125, neni 30, neni 41, neni 42, neni 43, evidence 1.28, tabela 24 ASCAL</i>), përfaqësimi i studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese është i garantuar. Ata marrin pjesë në disa organe kolegjiale: Senati Akademik, Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, Këshilli i etikës (<i>evidence 1.27</i>). Gjithashtu studentët marrin pjesë në grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësimin e programeve të studimit dhe vlerësimin institucional (<i>evidence 5.28</i>). Nga evidencat rezulton që ata janë dhe pjesë e vlerësimit të mësimdhënies dhe personelit akademik, nëpërmjet pyetsorëve që organizohen periodikisht me ta.</p> <p><i>Mbetet si detyrë nxitja e pjesëmarrjes më të madhe të studentëve në procesin e pyetësorëve duke siguruar në këtë mënyrë një feedback më të mirë, të plotë dhe real.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfaqësimi i studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese kolegjiale: Senati Akademik, Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, Këshilli i etikës është real nëpërmjet shprehjes së mendimit dhe votimit (<i>evidence 1.27</i>). Gjithashtu studentët marrin pjesë aktive reale në grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësimin e programeve të studimit dhe vlerësimin institucional (<i>evidence 5.23, evidence 5.24</i>). Nga evidencat dhe biseda me ta rezulton që ata janë dhe pjesë e vlerësimit të mësimdhënies dhe personelit akademik, nëpërmjet pyetsorëve që organizohen periodikisht me ta, të cilat rezulton që bëhen pjesë e analizës në departament për përmirësimin e programit të studimit. (<i>evidence 6.8, evidence 6.13, evidence 6.14, evidence 6.15, evidence 6.16, evidence 6.17, evidence 6.18, evidence 6.19</i>).</p> <p><i>Problem mbetet përqindja e ulët e pjesëmarrjes në pyetsorët e vlerësimit. Duhet gjetur mekanizma të tjerë për të nxitur rritjen e kësaj përqindje.</i> Gjithashtu studentët kanë dhe organizimet e tyre të sanksionuara në Rregullore të UT (<i>evidence 1.5, neni 86</i>). Janë ngritur dhe funksionojnë Këshillat Studentore në nivel institucional dhe njësisë kryesore të dala me votim (<i>evidence 5.22</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Matematik dhe Informatike”, rezulton që është i hartuar mbi bazën e VKM 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar, i shtrirë në 3 vite akademike, 6 semestra. Çdo semestër ka 30 kredite dhe një ngarkesë prej rreth 20-21 orësh në javë në auditor dhe harmonizim</p>

joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.	të formave të vlerësimit brenda një ngarkese normale (<i>evidencë 1.6, tabela 10 ASCAL</i>). Gjithashtu edhe njohja e plotë ose e pjeshme e studimeve të mëparshme nëpërmjet transferimit të krediteve përkatëse të fituara më përpara në IAL tjetër, kryhet konform Statutit të UT (<i>evidence 1.1, evidence 1.5, evidencë 1.17, evidencë 2.21</i>).			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit është e garantuar me pjesmarrjen reale të tyre në organet kolegjiale të përmendura më sipër, ku ata kanë mundësinë të shprehin mendimin dhe sugjerimet e tyre. Njëkohësisht ata kanë këtë mundësi edhe gjatë kryerjes së pyetsoreve në nivel departamenti dhe fakulteti, por edhe në kontaktet që kanë me Kujdestarin Akademik të vitit përkatës (<i>evidence 1.20</i>). Gjithashtu, nga biseda e GVJ me studentët, u konstatua që ata shprehin këto sugjerime dhe mendime në Këshillin Studentor.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Nga pikëpamja ligjore, në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e programit të studimit, studentëve ju garantohet plotësisht mundësia për të ankimuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe rezultatit në to, me një procedurë plotësisht të përcaktuar. Nga biseda e GVJ me studentët, rezultoi që kjo realizohet në realitet konform rregullores (<i>evidencë 1.5, neni 50, neni 51</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Bazuar tek dokumentat kryesore zyrtare ligjore të UT: Rregullore, Statut, Rregullore e programit të studimit etj. funksionojnë disa njësi të posaçme me kompetenca të përcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve: zyra IT, Njësia bazë, Kujdestari akademik, Dega e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës, Këshilli studentor, Biblioteka e FSHN, Sekretaria Mësimore (<i>evidence 1.1</i>). Nga biseda e GVJ me studentët rezultoi që të gjitha këto njësi janë funksionale.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,	Rezultoni që studentët informohen, këshillohen, asistohen në lidhje me çështje të procesit mësimor dhe programit të studimit, nëpërmjet: gjithë dokumentave zyrtare si rregullore e UT, rregullore e programit të studimit të cilat ndodhen të afishuara në faqet e FSHN dhe

<p>ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>departamentit. Njëkohësisht aty ndodhen dhe informacione të tjera që lidhen me procesin mësimor dhe infrastrukturën përkatëse në shërbim të studentëve. Në stendat informative ka të afishuara detaje lidhur me orarin mësimor, datat e provimeve, oraret e konsultimeve me personelin akademik. Gjithashtu, Kujdestari akademik i vitit përkatës është një tjetër burim i vazhdueshëm informimi dhe këshillimi. Po ashtu, Sekretaria mësimore është kontakti i parë dhe i vazhdueshëm për informacion për studentët.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Duke qenë se në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike nuk parashikohet praktikë profesionale, atëherë njësia që mbulon këshillimin e studenteve lidhur me zgjedhjet dhe orientimet e duhura për përparim profesional dhe tregun e punësimit, është Dega e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në bashkëpunim me Departamentin (<i>evidence 5.3, evidence 1.9</i>). <i>Përveç komunikimeve online, duhet të rriten takimet e drejtpërdrejta me studentët për informimin e tyre, kjo u konstatua edhe nga biseda me studentët. Kjo kërkon edhe rritjen e personelit përbërës të DNJSBC, nga dy që janë ndoshta në 4 vetë, duke patur parasysh volumin e punës që përballon kjo njësi që përfshin edhe këshillimin e karrierës.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Njësia që informon, këshillon dhe orienton studentët gjatë studimeve deri në diplomim me kontakte të drejtpërdrejta ose me material informuese, edhe në ciklin e dytë dhe më pas duke mbledhur të dhëna për punësimin e tyre edhe pas diplomimit është Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (<i>evidence 1.9</i>). Gjithashtu UT organizon në mënyrë periodike edhe panairt e punës ku studentët mund të marrin informacione direkt nga punëdhënësit të ndryshëm. (<i>evidence 5.25</i>)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton që UT në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare Statut etj. ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë. Është miratuar Manuali i Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohen qartë parimet dhe procedurat për zbatimin e tij. Janë ngritur strukturat në rang universiteti sic janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës etj. funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të tyre janë të përcaktuara në Statutin e UT (<i>evidencë 1.2, fq 4, evidencë 1.1, kreu X, nenet 138-141, evidencë 6.1, evidencë 6.2, evidencë 6.3, evidencë 6.4, tabela 24 ASCAL, evidencë 1.1, neni 140, fq. 73-74</i>). Gjithashtu, në vijim janë ngritur strukturat në rang njësie kryesore, siç është Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC apo DSBCCK) (<i>evidencë 1.1, evidence 6.5</i>), e cila ndër të tjerash në bashkëpunim me zv. Dekanin përkatës që mbulon Ciklin e parë dhe të Dytë të studimeve, organizon pyetësorët me studentët për cilësinë e mësimdhënies për disiplinat e programit të studimit, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. NJSBC harton raportet e vlerësimeve (<i>evidencë 1.1 neni 141, pika 3, fq. 74, evidencë 6.8, evidencë 6.11</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në UT, është funksional KPSSC si struktura përgjegjëse e ngarkuar nga Senati Akademik për të ndjekur dhe garantuar plotësimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Kjo strukturë përbëhet nga 11 anëtarë, 8 anëtarë personel akademik dhe 3 anëtarë studentë, ku FSHN përfaqësohet me 1 anëtar personel akademik. UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë si strukturën ndihmëse akademike që mbështet veprimtarinë e KPSSC dhe NJSBC në njësitë kryesore (<i>Tabela 24 ASCAL</i>). FSHN ka ngritur si strukturë funksionale, Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), e cila është në varësi të Dekanit, përbëhet nga dy punonjës me kohë të plotë, një kryetar dhe një specialist dhe veprimtaria e së cilës kryhet e bazuar në “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, mbështetur në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumentave të Cilësisë”, të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës (<i>evidencë 6.1, evidencë 6.2, evidencë 6.3, evidencë 6.4</i>). Nga verifikimi në realitet, rezultoi funksionale gjithë veprimtaria e saj.</p> <p><i>Përveç komunikimeve online, duhet të rriten takimet e drejtpërdrejta me studentët për informimin e tyre. Kjo kërkon edhe rritjen e personelit përbërës të DNJSBC, nga dy ndoshta në 4 vetë, duke patur parasysht</i></p>

	<i>volumin e punës që përballon kjo njësi që përfshin edhe këshillimin e karrierës.</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<p>UT, si detyrim ligjor, në 2018, ka kryer vlerësimin e brendshëm dhe më pas atë të jashtëm institucional të cilësisë, proces që u mbyll me akreditimin institucional për 4 vite akademike (<i>evidencë 1.8, evidencë 2.7</i>). Në këtë moment, është në zbatim instrumenti tjetër i sigurimit të cilësisë, akreditimi i programit të studimit. Është kryer vlerësimi i brendshëm, dhe është në proces vlerësimi i jashtëm.</p> <p>Nga evidencat përkatëse, rezulton që UT përgatit raportin vjetor mësimor-kërkimor për analizën e programeve të studimit dhe kurrikulave dhe përmirësimin e tyre në masën 20%, përdorimin e dokumentacionit të unifikuar të instrumenteve të vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë etj. (<i>evidencë 6.6</i>). Njëkohësisht, rezulton që UT ka hartuar gjithashtu planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024 (<i>Mungon evidence</i>). Siç rezulton dhe nga evidencat dhe bashkëbisedimi gjatë vizitës së GVJ në FSHN, DSBCK bashkëpunon dhe bashkërendon punën me departamentin për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Për të realizuar vlerësimin e brendshëm, ftohen studentët në mënyrë periodike të plotësojnë pyetësorët për të bërë vlerësimin e lëndëve të programit (<i>evidencë 6.8, evidencë 6.11</i>). Njëkohësisht, Departamenti i Matematikës së Aplikuar përpilon analizat vjetore ku ndër të tjera në të përfshihen edhe tipet e pyetësorëve të realizuar gjatë vitit akademik dhe konkluzionet përkatëse (<i>evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10</i>). Në bazë të tyre, hartohet nga Departamenti dhe plani i masave për përmirësim (<i>evidencë 6.12</i>).</p> <p><i>Problem ende mbetet përqindja e ulët e pjesëmarrjes së studentëve në plotësimin e pyetësorëve. Duhet gjetur mekanizma për të rritur pjesëmarrjen e tyre në plotësimin e pyetësorëve.</i></p>			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<p>Siç rezulton nga evidencat përkatëse dhe nga konstatimi në realitet, Universiteti i Tiranës ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike në kuadër të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në dokumentet zyrtare siç është Statuti i UT-së parashikohen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen (<i>evidencë 1.1, kreu X, nenet 138-141</i>).</p> <p>Në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentet dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë (<i>evidencë 6.3</i>) Njëkohësisht, në ndihmë të këtij procesi përveç pyetësorëve periodikë, Departamenti i Matematikës së Aplikuar harton dhe në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij dhe harton dhe panin e masave për përmirësim te mundshme (<i>evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10, evidencë 6.12</i>).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nat	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të Ciklit të parë, rezultojnë që UT ka të ngritura njësi të posaçme kryesore: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni Përhershëm i Kurrikulës etj (<i>Tabela 24 ASCAL</i>).</p> <p>Njëkohësisht, në nivel fakulteti, është ngritur dhe funksionon realisht Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (<i>Tabela 24 ASCAL</i>). Në këtë kuadër, dhe në mbështetje edhe të njësive të mësipërme, koordinimi i Përgjegjësit të Departamentit me zv. Dekanin që mbulon Ciklit të Parë të studimeve dhe zv. Dekanin që mbulon kërkimin shkencor, ndihmon në realizimin e analizave të punës mësimore-kërkimore dhe hartimin e raporteve përkatëse (<i>evidencë 1.30, evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10</i>), të cilat më pas integrohen në raportimet vjetore si FSHN (<i>evidencë 1.26(a,b,c)</i>).</p> <p><i>Do të ishte më efektive, të ngrihej në nivel departamenti, Këshilli i Programit të Studimeve (KPS) për çdo program studimi të çdo cikli, i përbërë psh nga 2-3 personel akademik dhe 1 student, i cili do të monitoronte dhe shqyrtonte problematikat e programit të studimit, duke i sugjeruar përgjegjësit të departamentit dhe strukturave të tjera ndryshimet e nevojshme.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Nga evidencat përkatëse, rezultojnë që, përdoren disa mekanizma për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë: raportet vjetore në rang departamenti dhe fakulteti e më tej në rang universiteti, që marrin në analizë punën mësimore-kërkimore; nga praktika konkrete të evidentuara, rezultojnë që ndiqen procedura standarde të bazuara në ligjin e arsimit të lartë, VKM, udhëzimet e MAS dhe dokumentet zyrtare ligjore të UT, për ndryshime në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike. Gjithashtu, hartohen dhe zbatohen një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore (<i>evidencë 2.17, evidence 2.22(a,b)</i>) të cilat rezultojnë pas plotësimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies i cili realizohet për disiplinat e programit të studimit në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve (<i>evidencë 5.21, evidencë 6.6, evidencë 6.11, evidencë 6.12, evidence 1.30, evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10, evidencë 1.26(a,b,c)</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës në FSHN përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve të cilat bazohen në dokumentin "Paketa e instrumenteve të cilësisë" të miratuar nga Senati Akademik (<i>evidencë 6.1, evidencë 6.4</i>) Këto mekanizma përfshijnë: vlerësimin e lëndës nga studenti (pyetsor që plotësohet përpara provimit); vlerësimi i studentëve që diplomohen (pyetësor që</p>

	<p>plotësohet përpara se të marrin diplomën për cilësinë e programit të studimit; raporti i studentëve (pyetsor me studentët e diplomuar për cilësinë e arsimimit të tyre); vlerësimi i pedagogut (pyetsor që plotësohet nga studentët përpara provimit); Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu (i cili plotësohet nga çdo personel akademik në fund të çdo semestri në lëndët ku janë titullarë duke kryer një vetvlerësim dhe analizë bazuar në përqindjen e kalueshmërisë të studentëve dhe shpërndarjes së notave në përqindje).</p> <p>Prej tyre, prodhohen statistika për program studimi, për lëndët e programit të studimit, për metodat e mësimdhënies (rasti i veçante i përdorimit të platformës online në kohën e pandemisë) si dhe analiza për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programit mësimor aty ku shihet e nevojshme (<i>evidencë 6.13, evidencë 6.14, evidencë 6.15, evidencë 6.16, evidencë 6.17, evidencë 6.18, evidencë 6.19</i>). Të gjitha këto mekanizma janë të unifikuar dhe të përfshira në Manualin e Cilësisë, Paketën e instrumenteve të cilësisë të miratuara në Senatin Akademik (<i>evidencë 6.1</i>).</p> <p><i>Problem mbetet përqindja e ulët e pjesëmarrjes së studentëve në plotësimin e pyetsorëve. Ndoshta duhet të shtohet në këto mekanizma, edhe një vlerësim nga vetë personeli akademik, lidhur me infrastrukturën apo elemente të tjera të organizimit të institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Një ndër dokumentat bazë dhe të rëndësishëm që prodhohen nga mekanizmat e përmendura tek kriteri 3 më sipër, është raporti i veprimtarisë mësimore-kërkimore të Departamentit i cili hartohet dhe merret në analizë në fund të vitit akademik, për t'u integruar më tej në raportet në nivel fakulteti (<i>evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10, evidencë 1.26, evidence 1.30</i>). Në këto raporte gjenden të analizuar statistika të studentëve të regjistruar për çdo vit, të diplomuar për çdo vit, të ç'regjistruar, aktiviteti kërkimor i personelit akademik, përmirësimi i infrastrukturës, ngarkesa mësimore e personelit akademik, përqindja e kalueshmërisë dhe përqindja e të diplomuarve, të dhëna nga raportet e Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës lidhur me pyetsorët e studentëve etj.</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Të gjitha këto raporte të analizave vjetore në nivel departamenti, Fakulteti dhe raporti i DSBCK paraqesin përveç rezultateve të pritshme, edhe adresime të mangësive të ndryshme për përmirësimin e cilësisë. Raportet e DSBCK gjenden të publikuara edhe në faqen web të FSHN. Si një element shumë i rëndësishëm i përmirësimin të cilësisë së programit të studimit, kryhet dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik që bazohet tek Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, miratuar nga Senati Akademik (<i>evidencë 6.20, evidencë 6.21</i>) dhe ku parashikohen të qarta parimet, procedurat, kriteret, periudhat e vlerësimit. Njëkohësisht, ky proces kryhet edhe për personelin ndihmës akademik që bazohet në Manualin "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës të miratuar nga Senati Akademik (<i>evidencë 6.22</i>).</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Si elemente të rëndësishme të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit, janë analizat vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore të departamentit (<i>evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10</i>) të cilat më pas integrohen në analizat në rang fakulteti kryhen periodikisht çdo vit (<i>evidencë 1.26(a,b,c)</i>).</p> <p>Gjithashtu, pjesë e vlerësimit të brendshëm, janë dhe analizat çdo vit të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës, mbi bazën e pyetësorëve, të cilat publikohen edhe në rubrikën e vet në faqen web të FSHN.</p> <p>(<i>evidencë 6.13, evidencë 6.14, evidencë 6.15, evidencë 6.16, evidencë 6.17, evidencë 6.18, evidencë 6.19, evidence 6.23</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Përvoja e fundit e fituar nga UT gjatë hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm në 2018 në kuadër të akreditimit, ka shërbyer si një përvojë pozitive edhe për metodikën e punës por edhe për të formalizuar gjithë instrumentet e posaçme për vlerësimin e programit të studimit: Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, Rregullorja "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës si dhe njësi kryesore për mbikëqyrjen e këtij procesi: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës në rang universiteti dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës në rang fakulteti. (<i>evidencë 6.1, evidencë 6.2, evidencë 6.3, evidencë 6.4, evidencë 6.5, evidencë 6.20, evidencë 6.21, evidencë 6.22</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në</p>	<p>Nga verifikimi në realitet, rezultoi që në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies: analizat vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore në rang departamenti (<i>evidencë 6.7, evidencë 6.9, evidencë 6.10</i>), dhe më pas në nivel fakulteti (<i>evidencë 1.26</i>), të cilat pasqyrohen në raportet përkatëse ku analizohen të gjithë elementët matës të cilësisë; dekanati me strukturat e tij ushtrojnë kontrolle mbi kryerjen e procesit mësimor (<i>evidencë 3.40</i>), përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore (<i>evidence 2.8</i>) monitorojnë procesin e mësimit, realizimin e programit mësimor, veprimtarinë kërkimore-shkencore, realizimin e seancave laboratorike</p>

<p>auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>të studentëve, procesin e provimeve, performanca e personelit akademik (<i>evidence 3.8</i>). Gjithashtu, nga ana tjetër, DSBCK realizon pyetësorët periodikë me studentët dhe harton analizat dhe raportet përkatëse të cilat publikohen edhe në faqen web dhe merren në analizë nga departamenti (<i>evidencë 6.13, evidencë 6.14, evidencë 6.15, evidencë 6.16, evidencë 6.17, evidencë 6.18, evidencë 6.19, evidencë 6.23</i>). Programi mësimor, mbi bazën e sugjerimeve të bëra, është fleksibël dhe pasqyrohen ndryshimet deri 20% (<i>evidencë 2.17, evidence 2.22(a,b)</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Përdoren disa metoda dhe praktika të tërthorta vlerësimi: nëpërmjet pyetësorëve, merret mendimi dhe vlerësimi për cilësinë e programit të studimit nga studentët përpara diplomimit (<i>evidencë 6.4, evidencë 6.15</i>). Gjithashtu, merret dhe mendimi dhe vlerësimi i të diplomuarve për cilësinë e arsimimit në programin e studimit. Departamenti vetë kryen studim tregu nga vlerësimi i studentëve të diplomuar. UT kryen në rang institucional analizë të tregut të punës, për të parë tendencën e tregut të punës për të diplomuarit në programet e studimit, vështirësitë dhe analizohen elementët që duhen përmirësuar në cilësinë e programeve të studimit. Gjithashtu, departamenti realizon në fund të çdo semestri pyetësorin «Raport i vetëvlerësimit të lëndës» nga secili anëtar i personelit akademik i cili ndihmon të evidentohen edhe përmirësimet që duhen të bëhen për lëndët dhe ndryshimet në përputhje me standardet dhe kërkesat e ASCAL (<i>evidencë 6.4, evidencë 6.17</i>). Njëkohësisht, në procesin e vlerësimit të programit mësimor merr pjesë edhe personeli ndihmës akademik. (<i>evidencë 6.22</i>). Gjithashtu, një instrument i rëndësishëm për të tërhequr mendim dhe vlerësim mbi programin e studimit dhe sa i përgjigjet ai tregut të punës janë dhe studimet e tregut të punës të organizuara nga Universiteti i Tiranës (<i>evidence 1.9</i>) ku përfshihet dhe pjesa e Departamentit të Matematikës së Aplikuar. <i>Studimi i tregut të punës në nivel departamenti duhet të jenë më të shpeshta.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të</p>	<p>Mbështetur në gjithë dokumentet zyrtare të tij, UT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. (<i>evidencë 1.1, evidencë 1.2</i>).</p>

<p>interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Një nga aktorët e rëndësishëm të brendshëm janë studentët, të cilëve ju garantohet edhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës apo angazhohen edhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësime institucionale dhe të programit të studimit (<i>Tabela 24 ASCAL, evidencë 1.1, neni 41, 42, evidence 1.27, evidencë 5.23, evidence 5.24</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në dokumentet zyrtare si Statuti dhe të tjera, UT ka të sanksionuar një politikë dhe procedurë të brendshme të përcaktuar qartë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit (<i>evidencë 1.1, kreu X, nenet 138-141</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Siç rezultoi nga gjithë evidencat dhe verifikimi në terren, përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë njësia bazë (Departamenti i Matematikës së Aplikuar) dhe njësia kryesore (FSHN) me strukturat e saj, dhe roli i tyre kryesor në këtë proces garantohet në të gjitha dokumentet bazë të UT. FSHN ka përfaqësuesit e saj në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës (<i>evidencë 1.27, tabela 24 ASCAL</i>), kurse Departamenti ka përfaqësuesit e tij në Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës (<i>evidencë 1.27, tabela 24 ASCAL</i>). Në FSHN është ngritur dhe funksionon Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (<i>evidencë 1.12, evidencë 1.27, evidencë 6.5</i>) e cila organizon dhe mbikëqyr gjithë procesin e sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti. Studentëve ju garantohet pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet (<i>evidencë 1.27</i>), por edhe në strukturat e sigurimit të cilësisë së programit të studimit, ashtu dhe si faktor që jep mendime dhe vlerësime për përmirësimin e programit të studimit, qoftë direkt me anketimet, pyetsorët, procesit të këshillimit brenda Departamentit, ashtu edhe nëpërmjet Këshillit Studentor.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në respekt të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Të gjithë pyetsorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike janë të tilla që ruajnë anonimatit dhe konfidencialitetin e tyre (<i>evidencë 6.24</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose</p>	<p>Nga evidentimi i bërë, rezultojnë që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet Panairi i Karrierës të organizuara nga UT/ FSHN (<i>evidencë 5.25</i>) ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Gjithashtu është organizuar dhe “Java e Europës në Universitetin e</p>

<p>ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Tiranës” (<i>evidencë 5.25</i>) . Gjithashtu mobilitetet Erasmus kanë ndihmuar në këtë proces (<i>evidencë 5.16</i>).</p> <p>Nga takimi i GVJ në terren u konstatua që Departamenti i Matematikës së Aplikuar organizon takime me studentët (kryesisht në kuadër të lëndës “Njohje me profesionin”) duke ftuar here pas here ish student të këtij programi studimi që janë në punë në sektorë të ndryshëm dhe të cilët në takime me studentët aktuale paraqesin përvoja të tyre apo dhe paraqesin tema nga sektori i tyre i punës. Kjo i shërben motivimit me tepër të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti organizon edhe leksione të hapura nga vetë personeli akademik ose dhe të ftuar nga jashtë vendit (<i>evidencë 3.9, evidencë 3.10, evidencë 3.11, evidencë 3.12</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga UT/FSHN janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. UT ka krijuar programin e transparencës e cila është publike ne faqen web te tij https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/. Në faqet web të FSHN dhe UT bëhen publike Analiza e Pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Edhe Departamenti në faqen e vet bën publike dokumentacionet bazë që lidhen me programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Vlerësojmë se gjithë rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit që përpilojnë strukturat e institucionit respektojnë lirinë dhe etikën akademike, duke u bazuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (<i>evidencë evidencë 6.13, evidencë 6.14, evidencë 6.15, evidencë 6.16, evidencë 6.17, evidencë 6.18, evidencë 6.19</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezulton që rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash konkrete për përmirësimin e mangësive dhe dobësive që janë evidentuar nga procesi i anketimeve me studentët dhe vetvlerësimi i personelit akademik. <i>(evidencë 6.11, evidencë 6.12).</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programeve të studimit është objektiv i sanksionuar institucional i UT (<i>evidence 1.2</i>). Duke shqyrtuar psh planin e masave të propozuara nga Departamenti i Matematikës së Aplikuar (<i>evidencë 6.11, evidencë 6.12</i>) pas proceseve të vlerësimit të programit të studimit, vlerësojmë si efektive veprimtaritë në kuadër të vlerësimit të cilësisë. Këto masa konsistojnë në përditësimin me njohuri të reja të përmbajtjeve e disiplinave të ndryshme, rritja e orëve të ushtrimeve apo seancat laboratorike në disa disiplina, që kërkojnë më tepër njohuri praktike, rritje e aktiviteteve ekstrakurrikulare, përmirësimi i metodave të mësimdhënies dhe teknologjisë së mësimdhënies, masa për motivim të studentëve për rritje të frekuentimit të leksioneve dhe ushtrimeve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga verifikimi në realitet, rezulton se Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës organizon aktivitete dhe leksione informuese me personelin akademik dhe studentët në bashkëpunim me Këshillin Studentor, me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion (<i>evidencë 5.3</i>).</p> <p><i>Duhet të rritet komunikimi i drejtpërdrejtë me studentët për informimin e tyre për aspekte të ndryshme, përveç komunikimit online. Për këtë sugjerojmë që të shikohet mundësia e rritjes së numrit të personelit në përbërje të kësaj dege që të përballojë gjithë këtë aktivitet të kësaj dege.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Qëndrueshmëria e personelit akademik efektiv nga Departamenti i Matematikës së Aplikuar siguron besimin e institucionit ndaj këtij programi dhe përkushtimin e stafit kundrejt studentëve.
2. Angazhimi nga Departamenti i Matematikës së Aplikuar i një personeli akademik të kualifikuar dhe me përvojë duke siguruar një mbulim të mirë të procesit mësimor dhe për pasojë garanton një cilësi të mirë të procesit të mësimdhënies/ nxënies.
3. Kurrikula e programit të studimit përshtatet me misionin dhe objektivat e këtij programi. Dijet e ofruara ju mundësojnë studentëve një profilizim të përshtatshëm për të vazhduar studimet Master dhe përputhjen me nevojat e tregut të punës.
4. Krijimi dhe fuqizimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimeve të Departamentit me ish-studentë të programit të studimit, të suksesshëm në karrierat e tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit, me institucione dhe kompani brenda vendit, ndikojnë pozitivisht në tërheqjen e studentëve në programin e studimit dhe motivimin e tyre gjatë studimeve dhe pas tyre.
5. Biblioteka e pasur dhe pajisur me libra fizikë dhe online në mbështetje të procesit të mësimnxënies dhe kërkimit.
6. Universiteti angazhon studentët në organet vendimmarrëse dhe këshillimore në hartimin, miratimin, rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies si një garanci e cilësisë.

Pika të dobëta:

1. Programi i studimit nuk ka një studim të vazhdueshëm periodik tregut të punës i cili do të mundësonte vlerësimin e raporteve të drejta mes lëndëve të matematikës teorike me ato të matematikës së aplikuar (**Standardi I.3, kriteri 2; Standardi I.5, kriteri 3**).
2. Mungesa e praktikës në kurrikulën e programit të studimit (**Standard II.1, kriteri 5; Standardi II.4, kriteri 2; Standardi V.3, kriteri 3**).
3. Numër i ulët i orëve laboratorike të parashikuara për këtë program studimi si dhe numri i vogël i ambienteve laboratorike të cilat rezultojnë të mbingarkuara (**Standard II.1, kriteri 4, 5; Standardi II.2, kriteri 3; Standardi III.3, kriteri 2, 7; Standardi IV,3, kriteri 1, 4**).
4. Syllabuset nuk janë plotësisht në përputhje me formatin e parashikuar në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, në disa lëndë titullari nuk është me kualifikimin e duhur si dhe literatura e përdorur, jo gjithmonë është e përditësuar në 5 vitet e fundit (**Standardi II.1, kriteri 6; Standardi II.2, kriteri 6,7; Standardi II.4, kriteri 6; Standardi III.3, kriteri 4**).

Rekomandime:

1. Të zhvillohet një studim tregu periodik specifik për këtë program studimi, përtej atij institucional
2. Të parashikohet futja në planin mësimor lënda “Praktikë Profesionale”.
3. Të rritet numri i krediteve/orëve për aktivitete laboratorike së bashku me shtimin e ambienteve laboratorike në fushën e informatikës specifikisht për këtë program studimi.
4. Të përditësohen syllabuset e lëndëve me litaraturë të azhornuar, sidomos për lëndët e formimit karakterizues (pjesë e kompetencës së njësisë bazë përgjegjëse).
5. Të ngrihen Këshillat e Programit të Studimit (KPS) në nivel njësie bazë për programet e studimit që ofron dhe në veçanti për këtë program studimi.




Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program "Bachelor in " Mathematical and Informatics Engineering" of Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths and affirmations:

1. The stability of the effective academic staff from the Department of Applied Mathematics ensures the trust of the institution towards this program and the commitment of the staff towards the students.
2. The engagement by the Department of Applied Mathematics of a qualified and experienced academic staff ensuring a good coverage of the teaching process and consequently guaranteeing a good quality of the teaching/learning process.
3. The curriculum of the study program is adapted to the mission and objectives of this program. The knowledge provided provides students with a suitable profile to continue their Master's studies and match the needs of the labor market.
4. The creation and strengthening of relations and collaborations of the Department with former students of the degree course, established in their professional career at home and abroad and with local institutions and companies, have a positive effect on the attractiveness of students in the course degree and their motivation during and after their studies.
5. Rich library equipped with physical and online books to support the learning and research process.
6. The university engages students in decision-making and advisory bodies in the drafting, approval, revision and improvement of curricula and teaching methods as an assurance of quality.

Weak points:

1. The study program does not have a continuous periodic study of the labor market which would enable the evaluation of the right ratios between the subjects of theoretical mathematics and those of applied mathematics (**Standard I.3, criterion 2; Standard I.5, criterion 3**).
2. Lack of professional practice in the curriculum of the study program (**Standard II.1, criterion 5; Standard II.4, criterion 2; Standard V.3, criterion 3**).
3. Low number of laboratory hours provided for this study program and small number of laboratory premises which are overcrowded (**Standard II.1, criterion 4, 5; Standard II.2, criterion 3; Standard III.3, criterion 2, 7; Standard IV, 3, criterion 1, 4**).
4. Syllabus are not fully in accordance with the format provided in VKM No. 879, dated 18.12.2019, in some subjects the akademik head does not have the appropriate qualification, as well as the literature used, it is not always updated in the last 5 years (**Standard II.1, criterion 6; Standard II.2, criterion 6,7; Standard II.4, criterion 6; Standard III.3, criterion 4**).



Recommendations:

1. To carry out a periodic and specific market study for this degree course, in addition to that at an institutional level
2. Include the "Professional Practice" course in the curriculum of the study plan.
3. To increase the number of credits/hours for laboratory activities also with augmenting laboratory facilities in the field of informatics specifically for this study program.
4. Update subject syllabuses with up-to-date literature, especially for core training subjects (responsibility of the department).
5. To set up Study Program Councils (SPC) at the department level for the study programs it offers and in particular for this study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen përmuesisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

